



Gjeta Katolike


Botues: Kisha Katolike "Zoja e Shkodrës" New York

Viti LVI Nr. 1-4, Janar-Dhjetor 2021, Çmimi \$5.00

“Ajo ... e mbështolli në shpërgënj dhe e vendosi në grazhd, sepse në bujtinë nuk pati vend për ta.” (Lk. 2:7)



Gëzuar Krishtlindja!

**Botues:**

Kisha Katolike Zoja e Shkodrës

Drejtor:

Dom Pjetër A. Popaj

Kryeredaktor:

Mark K. Shkreli

Redaktor (anglisht):

Simon Vukel

Redaktor (shqip):

Klajd Kapinova

Graphic Design

Ismer Mjeku

Marketing

Fran Çotaj

Website:

Martin Smajlaj

Këshilli Botues:

Dom Pjetër A. Popaj

Mark K. Shkreli

Klajd Kapinova

Simon Vukel

Peter Saljanin

Ismer Mjeku

Martin Smajlaj

Fran Çotaj

Pashko Rr. Camaj

Gjon Chota

Tomë Paloka

Lekë Perleshi

Gjeto Turmalaj

Mhill Velaj.

Të gjitha shkrimet dhe artikujt
i nënshtrohen redakturës.

Dorëshkrimet dhe fotografitë
nuk kthehen edhe nëse nuk
botohen.

Parapagimi: \$30 në vit**ADRESA E REDAKSISË:**

361 W. Hartsdale Ave,
Hartsdale, New York 10530
Tel. (914) 761-3523
Fax (914) 949-2690
e-mail: ShkreliM@aol.com

P Ë R M B A J T J A

CONTENTS

Viti LVI, Numri 1-4, Janar-Dhjetor 2021
Çmimi \$5.00 • www.jetakatolike.com

Dom Pjetër Popaj: Krishtlindja-Festë e Qiellit dhe e Tokës	3
Papa Françesku: "Urbi et Orbi" Message for Christmas	4
Papa Françesku: "Urbi et Orbi" Porosia për Krishtlindje	5
Mesazhi i Pashkëve dhe Bekimi i Papës Drejtuar Romës e Botës	7
Fr. Derek Sakowski: The Descent of Jesus	8
Frank Shkreli: 90-vjetori i Radio Vatikanit	11
Gjon Pali I do të Lumnohet nga Papa Françesku	12
Imzot Arjan Dodaj Kryepeshkëv i ri i Tiranë-Durrës	12
Papa Françesku: Martesa është gjë e bukur, duhet durim, por ia vlen	14
Mark K. Shkreli: Vajosja e të Sëmundurve dhe Ritet e Fundit të Një Katoliku	15
Frank Shkreli, Keze Kozeta Zylo, Gjeto Turmalaj: Ndërroi jetë poeti Luigj Çekaj ..	17
Dom Fatmir Koliqi: Shenjtërit e Ulpianës	22
Nënë Tereza: Vetëm Për Gra të Veçanta	26
Festa e Shën Markut, autorit të Ungjillit më të lashtë	27
Klajd Kapinova: Një Requiem i vonuar për Kolec Çefën	30
Frank Shkreli: Lezha Legjendare nderon Monsinor Dr. Zef Oroshin	33
Nikolin Sh. Lëmezhi: Poezi	35
Zef Giuseppe Chiaramonte: Arbëreshët dhe regjimi i Krishtërimt	36
Lëvizjet Demografike	37-39



Krishtlindje 2021, Kisha Katolike Zoja e Shkodrës.

KRISHTLINDJA

FESTË E QIELLIT DHE E TOKËS



Dom Pjetër Popaj

Shumëherë fëmijët pyesin: Engjujt e shenjtërit a e kremtojnë Krishtlindjen në Parriz? Përgjigja është: Pse jo! Kjo festë është e mbushur me gëzim, paqe e dashuri.

Çdo ditë ne besojmë është gëzim në Parriz. Por ky gëzim rritet edhe më shumë për Krishtlindje me këngët e koreve të engjëjve, shndritjen e dritave sikur ylli ndriçues i Bethlehemit.

Të imagjinojmë gëzimin e Zojës së Bekuar dhe të gjithë shenjtërve.

Jemi të grishur t'ju lutemi atyre që të na i çelin dyertë e parrizit që gëzimi i tyre të rrjedhë edhe mbi ne e mbi botën mbarë.

Çka është gëzimi i Krishtlindjes? Kuptimi në përgjithësi, simbas C.S. Lewis, është ndryshe nga çka është "kënaqësi". Gëzimi del nga thellësia e shpirtit, është më i pasur, del spontanisht pa prituri. Sikur e thotë Shën Augustini: Se Zoti na ka krijuar për veten e Tij dhe zemrat tona nuk pushojnë deri që të pushojnë në Të, bukuria e lashtë dhe e re.

Kur vejmë Zotin si numër një në jetë dhe mandej të tjerët dhe në fund vetën tonë, atëherë e kuptojmë domethënien e Gëzimit të Krishtlindjes. Krishti vetë është Gëzimi dhe Dhurata më e madhja e Krishtlindjes. Ai që dërguar prej Atit që të bëhet një me ne në



gjithçka-përveç mëkatit.

Kjo dhuratë i që dhënë Zojës së Bekuar më së pari, duke lindur e pa mëkat, mandej të gjithë neve që të shpëtojmë prej mëkatit e vdekjes së përherëshme.

Në Ungjillin e Sh. Gjonit theksohet: Vërtet, Hyji aq fort e desh botën sa që e dha një të vetmin Birin e vet kështu që, secili që beson në të, të mos birret por ta ketë jetën e pasur. Në të vërtetë Hyji nuk e dërgoi Birin që ta denojë botën, por që bota të shpëtojë nëpër të." (Gjn. 3:16-17)

Ky Gëzim është përplotësimi i të gjitha dëshirave të mbarë njerëzim-it. Është dhuratë qiellore që kremtohet në qiell dhe në tokë. Çdo dhuratë tjetër për Krishtlindje duhet të reflektojë këtë dhuratë të paçmuar.

Për çdo Krishtlindje jemi të thirrur që të bashkohemi me gëzimet qiellore, me Zojën e Bekuar, Shën

Jozefin, me engjëjt e shenjtërit duke kënduar këngën engjëllorë "Lavdi Hyjit në lartësi qiellore e paqë njerëzve vullnetmirë mbi tokë".

Në këtë festë e imagjinojmë Parrizin si vend gëzimi, paqe e lumturie. Me këtë u bashkangjitemi fjalëve të Krishtit që thotë: "Jua thashë këto, që gëzimi im të jetë në ju e gëzimi i juaj të jetë i plotë." (Gjn.15:11) Sikur Ai që na e ka sjellur gëzimin qiellor për t'i mbushur zemrat tona këtu mbi tokë, ashtu lutemi që këto gëzime të vazhdojnë edhe në jetën tjetër.

Prandaj, ne duhet të falënderojmë Zotin për këtë dhuratë të paçmuar, të dashurisë e të paqes. Dhe lutemi që të na ndihmojë të bëhemi mbarështues të këtij gëzimi edhe për të tjerët që nëpër të shijojmë gëzimet qiellore për çdo Krishtlindje.

Gëzuar Krishtlindjen!



"URBI ET ORBI" MESSAGE OF HIS HOLINESS POPE FRANCIS CHRISTMAS 2021

Dear brothers and sisters, Merry Christmas!

The Word of God, who created the world and who gives meaning to history and to humanity's journey, became flesh and came to dwell among us. He came like a whisper, like the murmur of a gentle breeze, to fill with wonder the heart of every man and woman who is open to this mystery.

The Word became flesh in order to dialogue with us. God does not desire to carry on a monologue, but a dialogue. For God himself, Father, Son and Holy Spirit, is dialogue, an eternal and infinite communion of love and life.

By the coming of Jesus, the Person of the Word made flesh, into our world, God showed us the way of encounter and dialogue. Indeed, he made that way incarnate in himself, so that we might know it and follow it, in trust and hope.

Sisters and brothers, "what would our world be like without the patient dialogue of the many generous persons who keep families and communities together?" (Fratelli Tutti, 198). In this time of pandemic, we have come to realize this more and more. Our capacity for social relationships is sorely tried; there is a growing tendency to withdraw, to do it all by ourselves, to stop making an effort to encounter others and do things together. On the international level too, there is the risk of avoiding dialogue, the risk that this complex crisis will lead to taking shortcuts rather than setting out on the longer paths of dialogue. Yet only those paths can lead to the resolution of conflicts and to lasting benefits for all.

Indeed, even as the message of the birth of the Saviour, the source of true peace, resounds in our hearts and in the whole world, we continue to witness a great number of conflicts, crises and disagreements. These never seem to end; by now we hardly even notice them. We have become so used



to them that immense tragedies are now being passed over in silence; we risk not hearing the cry of pain and distress of so many of our brothers and sisters.

Let us think of the people of Syria, who for more than a decade have experienced a war that has resulted in many victims and an untold number of displaced persons. Let us look to Iraq, which still struggles to recover from a lengthy conflict. Let us listen to the cry of children arising from Yemen, where an enormous tragedy, overlooked by everyone, has silently gone on for years, causing deaths every day.

Let us recall, too, the continuing tensions between Israelis and Palestinians that drag on without a resolution, with ever more serious social and political consequences. Nor should we forget Bethlehem, the place of Jesus' birth, which is experiencing hardship also from the economic repercussions of the pandemic, preventing pilgrims from visiting the Holy Land and adversely affecting the life of the people. Let us think of Lebanon, which is undergoing an unprecedented crisis, accompanied by very troubling economic and social conditions.

Yet, in the heart of the night, look! The sign of hope! Today, "the Love that moves the sun and the other stars" (Paradiso, XXXIII, 145), as Dante says, became flesh. He came in human form, he shared in our plight and he broke down the wall of our indifference. In the cold of the night, he stretches out his tiny arms towards us: he is in need of everything, yet he comes to give us everything. Let us ask him for the strength to be open to dialogue. On this festive day, let us implore him to stir up in the hearts of everyone a yearning for reconciliation and fraternity. Let us now turn to him in prayer.

Baby Jesus, grant peace and concord to the Middle East and the whole world. Sustain all those who provide humanitarian aid to peoples forced to flee from their homelands; comfort the Afghan people, who for more than forty years have been sorely tested by conflicts that have driven many to leave the country.

King of all peoples, help political authorities bring peace to societies roiled by tension and conflict. Sustain the people of Myanmar, where intolerance and violence not infrequently target the Christian community and its places of worship, clouding the peace-

ful countenance of that people.

Be a source of light and support for all those who believe in and strive, despite all obstacles, to advance encounter and dialogue. In Ukraine, prevent fresh outbreaks of a long-festering conflict.

Prince of Peace, help Ethiopia to find once again the path of reconciliation and peace through a forthright encounter that places the needs of the people above all else. Listen to the plea of those living in the Sahel region, who experience the violence of international terrorism. Turn your gaze to the peoples of the countries of North Africa, tormented by divisions, unemployment and economic inequality. Alleviate the pain of our many brothers and sisters who suffer from internal conflicts in Sudan and South Sudan.

Grant that, through dialogue, mutual respect and recognition of the rights and cultural values of every human being, the values of solidarity, reconciliation and peaceful coexistence may prevail in the hearts of the peoples of the Americas.

Son of God, comfort the victims of violence against women, which has increased in this time of pandemic. Offer hope to young children and adolescents suffering from bullying and abuse. Show consolation and warmth to the elderly, especially those who feel most alone. Give serenity and unity to families, the first educators of their children and the basis of the fabric of society.

God-with-us, grant health to the infirm and inspire all men and women of good will to seek the best ways possible to overcome the current health crisis and its effects. Open hearts to ensure that necessary medical care – and vaccines in particular – are provided to those peoples who need them most. Repay those who generously devote themselves to caring for family members, the sick and the most vulnerable in our midst.

Child of Bethlehem, grant that the many military and civilian prisoners of war and recent conflicts, and all those imprisoned for political reasons, may soon return home. Do not leave us indifferent before the tragic situa-

tion of migrants, displaced persons and refugees. Their eyes beg us not to look the other way, ignoring our common humanity, but instead to make their stories our own and to be mindful of their plight.

Eternal Word become flesh, make us attentive to our common home, which is suffering from the carelessness with which we so often treat it. Inspire political leaders to reach effective agreements, so that future generations can live in an environment respectful of life.

Dear brothers and sisters, amid all the many problems of our time, hope prevails, “for to us a child is born” (Is 9:6). He is the word of God, who became an infant, capable only of crying, and in need of help for everything. He wished to learn how to speak, like every other child, so that we might learn to listen to God, our Father, to listen to one another and to dialogue as brothers and sisters.

O Christ, born for our sake, teach us to walk beside you on the paths of peace.

Merry Christmas to all!

Mesazhi Krishtlindjes, Papa: Zoti ka lindur mes krizave të botës, por shpresa është më e fortë

Të dashur vëllezër e motra, gëzuar Krishtlindjen!

Fjala e Zotit, që krijoi botën e i jep kuptim historisë dhe udhës së njeriut, u mishërua dhe erdhi të banojë ndër ne! U duk si një pëshpëritje, si mërmërimë e një ere të lehtë, për ta mbushur plot me mahnitje zemrën e çdo burri e të çdo gruaje.

Fjala u bë njeri për të dialoguar me ne. Zoti nuk dëshiron të flasë me vete. Sepse vetë Zoti, Atë e Bir e Shpirt i Shenjtë, është dialog i amshuar e i pambarim bashkimi, dashurie e jete.

Duke ardhur në botë, në Vetjen e Fjalës së mishëruar, Zoti na tregoi udhën e takimit e të dialogut. Madje Ai vetë e mishëroi në vetvete këtë Rrugë, që ne të mund ta njohim e të mund ta përshkojmë me besim e



shpresë.

Motra, vëllezër, “çfarë do të ishte bota, pa dialogun durimtar të shumë njerëzve të fisëm, që i mbajtën të bashkuara familjet e bashkësitë? (Enc. Fratelli tutti, 198). Në këtë kohë pandemie ne mund ta kuptojmë edhe më shumë këtë. Aftësia jonë për marrëdhënie shoqërore u vu në provë të rëndë; thellohet prirja për t’u mbyllur brenda vetes, për ta bërë gjithçka vetë, për të hequr dorë nga dalja, nga takimi, nga dëshira për ta bërë gjithçka së bashku. E edhe në nivele ndërkom-bëtare ndjehet rreziku që kriza e ndërlikuar të nxisë për të zgjedhur rrugët më të shkurtëra, para rrugëve më të gjata të dialogut; por vetëm këto të çojnë në zgjidhjen e konflikteve me përfitime të përbashkëta e afatgjata.

E ndërsa jehon rreth nesh e në mbarë botën kumti i lindjes së Shëlbuesit, burim i paqes së vërtetë, shikojmë akoma një mori konfliktesh, krizash, kontradiktash. Të duket se nuk do të mbarojnë kurrë, e gati-gati nuk kujtohem më për to. U mësua deri në atë pikë, sa tragjedi të pafundme kalojnë tashmë në heshtje të thellë; rrezikohemi të mos e dëgjojmë britmën e dhimbjes e të dëshpërimit të një mori vëllezërish e motrash.

Të mendojmë për popullin sirian, i cili e jeton prej më se një dhjetëvjeçari luftën, që shkaktoi një mori viktimash e një numër të pallogaritshëm refugjatësh. Të shikojmë Irakun, që përpigjet të ngrihet përsëri në këmbë, pas konfliktit të pafundmë. Të dëgjojmë britmën e fëmijëve, që lartohet nga Jemeni, ku një tragjedi përbindshme, e harruar nga të gjithë, vijon në heshtje, duke shtuar çdo ditë numrin e të vdekurve!

Të kujtojmë tensionet e vazhdueshme ndërmjet izraelitëve e palestinezëve, që hiqen zvarrë, pa gjetur zgjidhje, me pasoja gjithnjë më të rënda shoqërore e politike. E, të mos e harrojmë Betlehemin, vendin ku pa dritën Krishti, i cili jeton kohë të vështira edhe për arsye ekonomike, shkaktuar nga pandemia, që i pengon shtegtarët të arrijnë në Tokën Shenjte, me pasoja negative mbi jetën e popullsisë. Të mendojmë për Libanin, që vuan nga një krizë e paparë, në kushte ekonomike e shoqërore shumë

shqetësuese.

Por ja, në zemrën e natës, një shenjë shprese! Sot “dashuria, që vë në lëvizje diellin e yjet” (Par. XXXIII,145) siç shkruan Dante, u bë njeri! Erdhi në formë njerëzore, mori pjesë në dramën tona, e rrënoi murin e indiferencës sonë. Në akullinën e natës i shtrin krahët e tij të vegjël drejt nesh: ka nevojë për gjithçka, por vjen të na dhurojë gjithçka. Atij t’ia kërkojmë forcën për të hapur dialogun. Në këtë ditë feste, ta lusim të ngjallë në zemrat e të gjithëve dëshirën e zjarrtë të pajtimit e të vëllazërimit. Atij t’ia drejtojmë lutjen tonë!

O Krishti Fëmijë, dhuroja paqen e harmoninë Lindjes së Mesme e botës mbarë. Ndihamoji ata, që angazhohen t’i japin ndihmë humanitare popull-sive të detyruara të ikin nga atdheu i tyre; ngushëlloje popullin afgan, i cili që prej dy vjetësh vihet në provë të rëndë nga ndeshjet, që e detyruan shumëkënd të largohet nga Vendi.

O Mbret i popujve, ndihmoji autoritetet politike ta paqëtojnë shoqërinë e trazuar nga tensionet dhe kontrastet. Mbështete popullin e Mianmarit, ku intoleranca e dhuna godasin shpesh edhe bashkësinë e krishterë e vendet e kultit, duke e errësuar fytyrën paqësore të kësaj popullsie.

Qofsh dritë e mbështetje për kë beson e vepron, duke shkuar edhe kundër rrymës, në favor të takimit e të dialogut e, mos lejo që në Ukrainë të përhapen metastazat e një konflikti të gangrenizuar.

O Princ i Paqes, ndihmoje Etiopinë të rizbulojë udhën e pajtimit dhe të paqes, nëpërmjet konfrontimit të sinqertë, që vë në vendin e parë nevojat e popullsisë. Dëgjoje britmën e popull-sive të rajonit të Sahelit, që përjetojnë dhunën e terrorizmit ndërkombëtar. Ktheji sytë drejt popujve të Afrikës së Veriut, që i mundon përçarja, papunësia dhe pabarazia ekonomike; lehtësoji vuajtjet e shumë vëllezërve dhe motrave, që vuajnë nga konfliktet e brendshme në Sudan dhe në Sudanin e Jugut.

Bëj që në zemrat e popujve të kontinentit amerikan të mbizotërojnë vlerat e solidaritetit, pajtimit dhe bashkëjetesës paqësore, përmes dialogut, respektit të ndërsjellë dhe njohjes së të drejtave dhe të vlerave kul-

turore të gjithë njerëzve.

O Biri i Zotit, ngushëlloji viktimat e dhunës kundër grave, që përhapet pa fre në këtë kohë pandemie. Jepu shpresë fëmijëve dhe adoleshentëve, të cilët ngacmohen dhe abuzohen. Jepu ngushëllim dhe dashuri të moshuarve, veçanërisht më të vetmuarve. Jepi qetësi dhe unitet familjes, vend parësor i edukimit dhe bazë e indit shoqëror.

O Zot-me-ne, jepu shëndet të sëmureve dhe frymëzoji të gjithë njerëzit vullnetmirë që të gjejnë zgjidhjet më të përshtatshme për kapërcimin e krizës shëndetësore dhe të pasojave të saj. Bëji zemrat bujare, që terapitë e nevojshme, sidomos vaksinat, t’u mbërrijnë popull-sive në nevojë. Shpërbleji të gjithë ata, që tregojnë vëmendje dhe përkushtim në kujdesin për familjarët, të sëmurët dhe më të brishtët.

O Foshnja e Betlehemit, jepu mundësinë të kthehen së shpejti në shtëpi të burgosurve të shumtë të luftës - civilë dhe ushtarakë - nga konfliktet e fundit dhe të burgosurve për arsye politike. Mos na lër të tregohemi indiferentë përballë tragjedisë së emigrantëve, të të shpërngulurve dhe të refugjatëve. Sytë e tyre na kërkojnë të mos kthehemi nga ana tjetër, të mos e mohojmë humanitetin, që na bashkon, t’i bëjmë tonat historitë e tyre dhe të mos ua harrojmë dramën.

O Fjalë e amshuar, që u mishërove, na bëj të vëmendshëm ndaj shtëpisë sonë të përbashkët, e cila vuan edhe nga pakujdesia me të cilën e trajtojmë shpesh dhe, nxiti autoritetet politike të gjejnë marrëveshje të frytshme që brezat e ardhshëm të jetojnë në një ambient, ku respektohet jeta.

Të dashur vëllezër e motra, të shumta janë vështirësitë e kohës sonë, por shpresa është më e fuqishme, sepse “një fëmijë lindi për ne” (Is 9,5). Ai është Fjala e Zotit dhe u bë foshnjë, në gjendje veç të qajë e të ketë nevojë për gjithçka. Deshi të mësojë të flasë, si çdo fëmijë, që ne të mësojmë si ta dëgjojmë Zotin, Atin tonë, si ta dëgjojmë njëri-tjetrin dhe të dialogojmë si vëllezër e motra. O Krisht, lindur për ne, na mëso të ecim me Ty në shtigjet e paqes.

Gëzuar Krishtlindjen të gjithëve!

Mesazhi i Pashkëve dhe bekimi i Papës Françesku drejtuar Romës e botës

Të dashur vëllezër e motra: Gëzuar Pashkët!

Sot në të katër anët e botës jehon kumtimi i Kishës: “Jezusi, i kryqëzuari, u ngjall, si pati thënë. Aleluja!”.

Kumtimi i Pashkëve nuk tregon ndonjë mirazh, nuk zbulon ndonjë formulë magjike, nuk rrëfen rrugëdaljen nga situata e vështirë, që po kalojmë. Pandemia është akoma në kulmin e vet e kriza shoqërore dhe ekonomike, shumë e rëndë, posaçërisht për më të varfërit: pavarësisht nga kjo - e është shkandulluese - konfliktet e armatosura nuk pushojnë e arsenalet ushtarake fuqizohen.

Përballë, a më mirë të themi, në mes të këtij realiteti kaq të ndërlikuar, kumti i Pashkëve përmbledh me pak fjalë një ngjarje, e cila të jep shpresën që nuk zhgënjën: “Jezusi, i kryqëzuari, u ngjall!”. Nuk na flet për engjëj, as për fantazma, por për një njeri, një njeri me mish e esh-

tra, me fytyrë e me emër: Jezus. Ungjilli dëshmon se ky Krishti, i kryqëzuar nën Poncin Pilat mbasi pati thënë se ishte Krishti, Biri i Zotit, në të tretën ditë u ngjall, sipas Shkrimeve e si ai vetë ua kishte parafolë dishepujve të vet.

I kryqëzuari, jo tjetërkush, u ngjall! Zoti Atë e ngjalli të Birin Jezus sepse bëri deri në fund të fundit vullnetin e Tij të shëlbimit: mori mbi vete ligësinë tonë, plagët tona, vetë vdekjen tonë: pësoi dhimbjet tona, mbartti barrën e mbrapshive tona. Prandaj Hyji Atë e lartoi e tani Jezu Krishti jeton përgjithmonë, është Zoti.

E dëshmitarët kumtojnë një hollësi të rëndësishme: Jezusi i ngjallur i mbart mbi vete plagët në duar, në këmbë, në brinjë.

Këto plagë janë vula e përhershme e dashurisë së tij për ne. Kushdo kalon ndonjë provë të vështirë, në korp a në shpirt, mund të gjejë strehë ndër këto

plagë e të marrë prej tyre hirin e shpresës, që nuk të zhgënjën.

Krishti i ngjallur është shpresë për të gjithë njerëzit, që vuajnë akoma për shak të pandemisë, për të sëmurët e për ata, që humbën njeriun e dashur. Zoti e ngushëllon dhe e mbështet punën e mjekëve e të infermierëve. Të gjithë, posaçërisht njerëzit më të ligshëm, kanë nevojë për asistencë e të drejtë për mjekimet e nevojshme. Kjo bëhet edhe më e qartë në këtë kohë, kur të gjithë jemi të thirrur për ta luftuar pandeminë e kur vaksinat janë mjeti kryesor në këtë luftë. Në frymën e “internacionalizimit të vaksinave”, e nxis mbarë Bashkësinë ndërkombëtare në angazhimin e përbashkët për ta shmangur çdo vonesë në shpërndarjen e tyre e për të favorizuar ndarjen e përbashkët, posaçërisht me vendet më të varfëra.

I Kryqëzuari i Ngjallur është ngushëllim për ata, që humbën punën a që kalo-



jnë çaste të vështira ekonomike, pa ndihmën e nevojshme shoqërore. Zoti e frymëzoftë veprimtarinë e autoriteteve publike që të gjithëve, posaçërisht familjeve më nevojtare, të mos u mungojnë ndihmat e nevojshme a mjetet e përshtatshme të jetesës.

Jezusi i ngjallur është shpresë për shumë të rinj, që detyrohen të kalojnë periudha të gjata pa ndjekur shkollën e universitetin e pa e kaluar kohën me miqtë. Të gjithë kemi nevojë të jetojmë marrëdhënie njerëzore reale e jo vetëm virtuale, posaçërisht në moshën kur formohet karakteri e personaliteti. Jam pranë të rinjve të mbarë botës e, në këtë orë, posaçërisht pranë atyre të Mianmarit, që angazhohen për demokracinë, duke ngritur paqësisht zërin, me vetëdijen se urrejtja mund të zhduket vetëm me dashuri.

Drita e të Ngjallurit qoftë burim rilindjeje për migrantët, në ikje nga lufta e mjerimi. Në fytyrat e tyre shohim fytyrën e shpërfyturuar e të vuajtur të Zotit, që ngjitet në Kalvar. Mos u mungofshin shenjat konkrete të solidaritetit e të vëllezërimit njerëzor, peng i fitores së jetës mbi vdekjen, që e kremtojmë këto ditë. Falënderoj vendet, të cilat i strehojnë me bujari të vuajturit në kërkim të strehës, posaçërisht Libanin e Jordaninë, që mikpresin një mori refugjatësh të ikur nga konflikti sirian.

Populli libanez, që po kalon një periudhë vështirësish e paqartësie, u ngushëlloftë nga Zoti i ngjallur e u ndihmoftë nga Bashkësia ndërkombëtare në thirrjen e tij të veçantë për të qenë tokë e takimit, e bashkëjetesës, e pluralizmit.

Krishti, paqja jonë, premtoftë më në fund të pushojë vringëllima e armëve në

Sirinë e dashur e të martirizuar, ku miliona njerëz jetojnë tashmë në kushte çnjerëzore, ashtu si në Jemen, ngjarjet e të cilit rrethohen me një heshje të shurdhër e shkandulluese; e në Libi, ku nëpërduket, më në fund, rrugëdalja nga një dhjetëvjeçar grindjesh e ndeshjesh të përgjakshme. Të gjitha palët në konflikt u angazhoshin vërtetësisht për t'u dhënë fund konflikteve e për t'u krijuar popujve të dërmuar nga lufta, mundësinë të jetojnë në paqe e të nisin rindërtimin e vendeve të tyre.

Ngjallja natyrisht, na çon në Jeruzalem. Për të i kërkojmë Zotit paqe e siguri (krh Ps. 122), që t'i përgjigjet thirrjes për të qenë vend takimi, ku të gjithë mund të ndjehen vëllezër e ku Izraelitë e Palestinezë të rigjejnë forcën e dialogut, për të arritur një rrugëzgjdhje të qëndrueshme, që i shikon dy shtetet duke jetuar pranë e pranë në paqe e prosperitet.

Në këtë ditë feste, mendimi im rikthehet edhe në Irakun, që pata gëzimin ta vizitoja muajin e kaluar e që lutem të mund ta vijojë udhën e nisur të paqëtimt, që kështu të realizohet ëndrra e Zotit për një familje njerëzore derëhapur e mikpritëse për të gjithë bijtë e vet[1].

Forca e të Ngjallurit i mbështetët popullsitë afrikane, ardhmëria e të cilave rrezikohet nga dhuna e brendshme e nga terrorizmi ndërkombëtar, posaçërisht në Sahel e në Nigeri, e po ashtu edhe në Tigray e Cabo Delgado. Vazhdoftë përpjekjet për gjetjen e rrugëzgjdhjeve paqësore të konflikteve, duke respektuar të drejtat e njeriut dhe shenjtërinë e jetës, në dialog vëllazëror dhe konstruktiv, me frymë pajtimi e solidariteti veprues.

Tepër luftëra e tepër dhunë ka akoma në botë! Zoti, që është paqja jonë, na ndihmoftë për ta mundur mendësinë e luftës. I ndihmoftë të burgosurit në konfliktë, posaçërisht në Ukrainën lindore e në Nagorni-Karabakh, të kthehen shëndosh e mirë në familjet e tyre e i frymëzoftë qeveritarët e mbarë botës për ta frenuar garën e armatimeve të reja. Sot, 4 prill, kremtohet Dita botërore kundër minave njerivrasëse, mjete djallëzore e të tmerrshme, që mbysin a gjymtojnë çdo vit njerëz të pafajshëm dhe e pengojnë njerëzimin në “ecjen e përbashkët ndër shtigjet e jetës, pa frikë nga kurthet e shkatërrimit e të vdekjes” [2]. Sa e mirë do të ishte bota pa këto mjete mortore!

Të dashur vëllezër e motra, edhe sive, në vende të ndryshme, shumë të krishterë i kremtuan Pashkët me kufizime të forta, nganjëherë edhe pa mundur të marrin pjesë në kremtimet liturgjike. Lutemi që këto kufizime, ashtu si çdo kufizim i lirisë së kultit e të fesë në botë, të zhduken e çdo njeri të mund të lutet e ta lumnojë lirisht Zotin.

Ndërmjet vështirësive të tjera, që po kalojmë, nuk duhet harruar kurrë se nga varrët e Krishtit u shëruam (cfr Pt 2,24). Në dritën e të Ngjallurit vuajtjet tona u shndërruan. Atje ku kishte vdekje, tani ka jetë; ku kishte vaj, tani ka ngushëllim. Duke rrokur Kryqin, Jezusi i dha kuptim vuajtjeve tona e tani lutemi që forca mirëbërëse të këtij shërimi të përhapet në mbarë botën. Gëzuar Pashkë e shenjta të gjithëve!

[1] *Krh Takimi ndërjetar në Ur, 6 mars*

The Descent of Jesus

— Fr. Derek Sakowski —

We enter another Holy Week. Jesus' hour has come. Although he begs his Father to allow the cup of suffering to pass, in the end Jesus freely and willingly plunges into his Passion for our sake. He drinks the cup to the dregs, descending fully into the depths of human misery, indeed into the very hell that our misused human freedom has

“created.”

I love this quotation from Charles de Foucauld (taken from André Daigneault's *The Way of Imperfection*):

“All his life, Jesus only descended: descending in his incarnation; descending in becoming a small child; descending in obedience; descending in becoming poor, abandoned, persecut-

ed, tortured; descending in reaching the last place.”

All this descent of Jesus is “for our sake” – as we profess in the Creed. He desires to redeem us and save us. The redemption he brings is so much more than standing in our place and paying the price on the Cross. Some Christians have a rather narrow or distorted view of atonement

that almost paints God as a vengeful and petty deity whose wrath can be appeased only by blood. Jesus reveals our Father to be eternally kind. To be sure, there is a great sense of justice in Jesus paying the price, but that standing in our place says much more about God fully respecting the gift and dignity of human freedom (and



its real consequences) than it says about him being in any way demanding.

Jesus tells us why he has come from heaven “for our sake” – to seek out and save what is lost (Luke 19:10). I wrote last time about the great dignity of our human nature, even after the fall. We all have deep and dark places in our hearts in which we feel broken and shattered, marred and disfigured, unlovely and unlovable. Jesus reveals to us that there is no place too deep or too dark for him to enter. His desire to descend is unlimited – or rather, limited only by our resistance to receiving him.

There is so much that is comforting in this message. Jesus is not deterred by how seriously and how often each of us has turned our backs on him. He prays for his persecutors. He does not flinch when his closest companions misunderstand him, abandon him, deny him, or betray him. At Peter’s third denial, Jesus turns toward him with a gaze of kindness that incites Peter to rush outside and shed bitter tears.

The deeper truth of Holy Week is that Jesus desires to descend fully and deeply into the worst of our human experiences in order to rescue us, heal us, transform us, and exalt us. Hebrews 5 tells us that Jesus not only offered prayers and supplications for us, but did so with louds sobs and tears. It was not simply a matter of paying a price. Rather, he freely and willingly united himself with every human experience of misery and suffering – every loss, every betrayal, every rejection, every abandonment, every single moment of darkness. Jesus descended.

Philippians 2 describes the dynamics. Jesus, though truly divine, freely chooses to descend, to empty himself completely and totally for our sake. He is therefore exalted and raised above every other creature. He does this, not for his own glory and exaltation (he had no need of it!), but “for our sake” – in order that where he is, we also may be (John 14:3).

Nor does Jesus descend in order to rescue and exalt the “good” people or the “good enough” people. We are all the lost sheep, the lost coin, his lost sons and daughters.

Remember whom he chose to hang around with the most – the poor, the lame, the crippled, and the outcasts – including those considered to be the worst of sinners.

I know in my own life I have often vacillated back and forth between a puffed-up confidence (as though I “have it all together”) and deep discouragement. In both cases, I am somehow trying to be my own savior. Meanwhile, I need only allow Christ to complete his descent into the places of my heart in which I feel the most desperate and discouraged, and his love begins to transform all.


True Christian humility always brings with it a twofold conviction: (1) My own radical poverty; and (2) unshakable confidence in God’s eternal mercy. This is the humility we see in the Virgin Mary and her Magnificat – her song of praise to God in the presence of Elizabeth (Luke 1:46-55). She deeply understands that all is gift, proclaiming God as her savior – AND she eagerly praises the amazing things he is doing in her and through her, so great that all generations henceforth will call her blessed.

At the Cross, Mary freely shares in the sufferings of her Son, having compassion not only on him, but on every lost child of God who stands in need of mercy. Her Son loves us, and therefore so does she. The fact that many of us keep messing things up does not for a moment cause him to falter in his descent, nor her to falter in her deep motherly compassion on those who suffer with her Son.

How many of us attempt (in our prayers or piety) to try to “go up” to God? How willing are we to be truly vulnerable, to let him see us fully, and to love us where we most need his love? Do we not sometimes take the lead of Adam and Eve in the fall, hiding ourselves from God and covering our nakedness? Toxic shame is one of the devil’s favorite tools to convince us that no one would ever love us as we are.

The descent of Jesus says otherwise. He desires every piece and fragment of our broken hearts. There is no limit to his desire to descend.

(From Catholic Spiritual Direction)



90-VJETORI I RADIO VATIKANIT



Frank Shkreli

Të premten që kaloi me datë 12 shkurt 2021 u shënua 90-vjetori i themelimit të radio Vatikanit. 90-vjet më parë, Papa Piu i XI kishte përshëndetur punonjësit e kësaj radioje duke i falenderuar ata për, “Punën tuaj që arrin deri në vendet më të humbura. Ecni përpara me guxim dhe krijimtari kur i flisni botës.” Ndërsa të premten, sipas radio Vatikanit, Papa aktual Françesku, duke përshëndetur në këtë përvjetor radio gazetarët, redaktorët dhe punonjësit e tjerë të kësaj radioje botërore, duke pasqyruar pikëpamjet e tij në lidhje me lirinë e medias dhe të fjalës së lirë, u bëri thirrje atyre që me punën e tyre të raportojnë të vërtetën dhe të ndërtojnë “të ardhmen me krijimtari”.

“Faleminderit për punën tuaj. Faleminderit për dashurinë që keni për të. Radio ka këtë gjë të bukur, që e çon fjalën edhe në vendet më të largëta. E sot e ndërthur edhe me pamje e me shkrime. Ecni përpara me guxim dhe krijimtari, duke i folur

botës e duke ndërtuar kështu, një komunikim të aftë, që të na bëjë të shohim të vërtetën e gjërave”, është shprehur Papa Françesku në 90-vjetorin e radio Vatikanit, që njihet botërisht edhe si Zëri i Papës dhe i Kishës Katolike.

Më kujtohej kur isha pranë Zërit të Amerikës në vitet e luftës së ftohtë dhe më vonë, se ekspertët e audiencave të

radio Vatikanit në gjuhën shqipe shënon datën 3 tetor 1951. Për drejtimin e programit të ri u thirr meshtari shqiptar në mërgim, Monsinjon Zef Shestani. Zëri i tij u dëgjua në valët e Radios së Papës më 3 tetor 1951, në orën 21, kur nisi transmetimi i parë i programit. Më vonë, Imz. Shestani thirri pranë tij si bashkëpunëtorë, Zef Palin, Andrea Shulin, motrën engjëlllore, Luçia Laca dhe, si bashkëpunëtorë të jashtëm, Atë Danjel Gjeçajn, emëruar nga Selia e Shenjtë “Përfaqësues shpirtëror i shqiptarëve katolikë të mërguar”.

Pesë vjetë më parë, me rastin e 55-vjetorit të transmetimeve shqip të radio Vatikanit, si një prej programeve më të vogla për nga transmetimet dhe për nga stafi, thuhej se “Duke qenë përherë një nga gjymtyrët më të ligështa të Radios së Papës, e kemi ndjerë veten të rrethuar më shumë se të gjitha programet e tjera me atë kujdes që tregojnë prindërit për fëmijën e vogël. Kemi pasur e kemi gjithn-



radiove ndërkombëtare e konsideronin radio Vatikanin si njërin prej 5-6 radiove më me influencë dhe ndër më të dëgjuarat, sidomos në vendet ish-komuniste të Evropës Lindore dhe Qendrore e që transmetonte në dyzina gjuhësh të huaja. Si të tillë, e konsideronim edhe si konkurrenca me programet tona të Zërit të Amerikës, veçanërisht për programet drejtuar disa vendeve ish-komuniste me popullsi dërmuese katolike, siç ishte Polonia.

Radio Vatikani ka një staf prej rreth 350 punonjësish të cilët transmetojnë në 41 gjuhët më të njohura të botës dhe jo aq të njohura, përfshirë gjuhën shqipe. Transmetimi i parë i

jë pranë, Atin e Shenjtë, që nuk ka munguar ta mobilizojë Kishën universale në ndihmë të Shqipërisë si dhe të ndërmjetësojë vazhdimisht pranë bashkësisë ndërkombëtare për fatet e vendit të shqiptonjave kemi ndjerë përherë praninë e Selisë së Shenjtë.”

Thuhej gjithashtu se Shqipëria, Kosova e të gjitha trevat Shqiptare kanë qenë gjithnjë në zemrën e vëmendjes e papëve të Romës, ndërkohë që ne e kemi dhënë dëshminë tonë përmes fjalëve të transmetuara ditë për ditë me mjetin e brishtë, por të fuqishëm, të valëve të radios, i vetmi që as regjimi më i ashpër komunist nuk mundi t’a bllokonte plotë-

sisht. Natyrisht, radio Vatikanit në gjuhën shqipe shprehet krenar që munda ta bëjë këtë shërbim në vitet më të errëta të historisë së Shqipërisë,

Telat me gjemba që ndanin Shqipërinë nga bota, nuk mundën ta ndalonin këtë zë shprese të hynte në shtëpitë e atyre që besonin e

në këndvështrimin ungjillor. Në fillim rrethi i bashkëpunëtorëve vijonte të ishte tepër i ngushtë. Radioja fliste. Por ishte një monolog i gjatë. Një monolog i dhimbshëm, më se 40 vjeçar. Asnjë përgjigje nga dëgjuesit. Asnjë zë nuk dëgjohej përtej telave me gjemba. Zërat shqiptarë të radio Vatikanit flisnin me maturi, me kujdes të madh. Një fjalë e papeshuar mirë, përtej perdes së hekurt mund të shkaktonte një valë të re martirizimi. Po, lavdi Zotit, erdhi dita e ëndërruar. Diktatura u shemb dhe filloi bashkëbisedimi me dëgjuesit. Deri në vitin 1988 programin në gjuhën shqipe e drejtoi Monsinjon Zef Shestani. Pas këtij viti ai u largua nga mikrofonit për arsye moshe e sëmundjeje, duke e lënë drejtimin në duart e Gjon Gjomarkajt. Gjomarkaj vijoi ta



Emisioni i parë në gjuhën shqipe i Radio Vatikanit drejtohej nga Don Zef Shestani

kur vendi që deklaruar zyrtarisht si i vetmi “shtet ateist” në botë. Por e njëjta radio dëshiron të vijojë ta shoqërojë ecjen e shqiptarëve në këtë epokë të re, në të cilën e vetmja paqe në liri, paqja politike e brendshme e ndërkombëtare, paqja shoqërore e mbi të gjitha paqësimi i zemrave është ende detyrë që qëndron para nesh, thuhej në deklaratën e emisionit shqip të radio Vatikanit me rastin e 85-vjetorit të saj, pesë vite më pare. Radio Vatikanit e realizoi këtë mision edhe gjatë krizës së Kosovës dhe angazhohen se do të bëjnë një gjë të tillë çdo ditë, duke u frymëzuar nga mësimet e Papës, në bashkim të thellë shpirtëror me Kishën katolike të pranishme në viset e gjuhës shqipe e me të gjithë burrat e gratë, veprimtarë e ndërtuesë të paqes. Në kohën kur regjimi komunist i Enver Hoxhës bëri çmos të mbyllte çdo gojë që fliste në emër të Zotit, kur u rrokullisën kumbonët nga kumbonaret e heshtën uratët në Kishat e shkallmuara, zëri i radio Vatikanit vijonte të niste mesazhe përtej perdes së hekurt, përtej Adriatikut anë e mbanë trojeve shqiptare. U çonte shqiptarëve mesazhet e Atit të Shenjtë, mesazhe ngushëllimi e durimi, qëndrueshmërie e ngrohtësie vëllazërore, shprese e paqeje.



Kardinali shqiptar Ernest Simon Troshani me Don David Gjurgjen, përgjegjës i radio Vatikanit në gjuhën shqipe

shpresonin në Zot. Selia e Shenjtë nuk i kishte harruar bijtë e vet të masakruar. Në fillimet e veta, programi i radio Vatikanit në gjuhën shqipe transmetonte tri herë në javë. Pastaj transmetimi u bë i përditshëm. Fillimisht, tematika ishte vetëm liturgjiko-kishtarë, por më vonë u pasurua, duke përfshirë dokumentet më të rëndësishme të papës, veprimtaritë dhe vizitat e Atit Shenjtë, për të vijuar me veprimtaritë e Kishës katolike në trevat Shqiptare e në botë, problemet e rëndësishme të etikës, të shoqërisë, të kulturës, letërsisë e artit, parë gjithnjë

drejtonte programin shqip deri në daljen e tij në pension, në vjeshtën e vitit 1992. Që nga kjo kohë, programi i gjuhës shqipe pranë radio Vatikanit e drejton aktualisht prifti nga Kosova, Don David Gjurgja. Në redaksi punojnë Katerina Nushi nga Prizreni, Ana Luka nga Shkodra dhe Klaudia Bumçi nga Tirana dhe një numër i konsiderueshëm bashkëpunëtorësh nga të gjitha trevat shqiptare në Ballkanin Perëndimor.

*Bazuar kryesisht në burime të radio Vatikanit

Gjon Pali I do të Lumnohet nga Papa Françesku më 4 Shtator 2022

Sipas lamit nga Radio vatikani, Gjon Pali I do të shpallet i Lum në Sheshin e Shën Pjetrit nga Papa Françesku, të dielën më 4 shtator 2022. Pas shpalljes së dekretit të 13 tetorit për shërimin e mrekullueshëm, që i atribuohet ndërmjetësimit të Papës Luciani, Kongregata për Çështjet e Shenjtorëve njofton datën e lumnimit të Papës venedikas, që u ul në fronin e Shën Pjetrit vetëm për një muaj, por mbeti përgjithmonë në zemrat e njerëzve.

Data e meshës, e cila do të kryesohet nga Papa, iu komunikua postulatorit të çështjes së kanonizimit, kardinalit Beniamino Stella dhe imzot Renato Marangoni-t, ipeshkëv i Belluno-Feltre, dioqezës ku më 23 nëntor 2003 u hap çështja, për t'u mbyllur më 9 nëntor 2017, me shpalljen e virtyteve heroike.

Papa i gjashtë i Lum

Gjon Pali I është i gjashti nga papët e shekullit XX, për të cilin filloi çështja e lumnimit dhe e kanonizimit, e cila tashmë e ka ngritur në kult për gjithë Kishën universale kujtimin e Papëve Piu X, Gjoni XXIII, Pali VI dhe Gjon Pali II. Për Papën Gjon Pali I pritet tani të përfundojë krejt udha, që do ta çojë drejt kanonizimit.



Dëshmia e Benediktit XVI

Interesante të vihet në dukje se gjatë procesit të lumnimit, ndërmjet viteve 2008 e 2015, u depozituan dëshmitë e 21 dëshmnitarëve, ndër të cilët merr rëndësi të veçantë ajo e Papës aktual të nderit, Benedikti XVI. Deri tani, ajo përbën një “unicum” historik, pasi ishte hera e parë që një Papë dëshmonte për njërin nga paraardhësit e tij. Më 17 tetor 2016, me dorëzimin e “Positio”, që përbëhej nga 5 vëllime me më se 3.600 faqe, përfundoi puna shkencore dhe përpiluese, e cila zgjati 8 vite. Pas gjykimit të Kongregatës, çështja u mbyll me dekretin e Papës Françesku për shpalljen e virtyteve heroike të Gjon Palit I, më 8 nëntor 2017. Mrekullia e shërimit të një vajze të vogël, sëmurë nga një formë e rëndë encefalopatie, iu njoh, siç e thamë, me dekretin e 13 tetorit 2021.

Papa emëron imzot Arjan Dodaj kryepeshkëv të ri metropolit të Tiranë-Durrësit

Papa Françesku emëroi sot imzot Arjan Dodaj, kryepeshkëv të ri të kryedioqezës së Tiranë-Durrësit. Imzot Dodaj është kryepeshkëv i tretë i kësaj Kisha në periudhën pas rënies së komunizmit, pasardhës i imzot Rrok Mirditës dhe i imzot George Frendos.

R.SH. - Vatikan

Dorëheqja dhe emërimi i Kryepeshkvit Mitropolit Tiranë-Durrës (Shqipëri)

Ati i Shenjtë pranoi dorëheqjen nga kujdesi baritor i Kryedioqezës Metropolitane Tiranë-Durrës (Shqipëri), paraqitur nga SH. T. Imzot George Frendo, O.P..

Ati i Shenjtë ka emëruar Kryepeshkëv Mitropolit të Tiranë-Durrës SH. R. Imzot Arjan Dodaj, FDC, deri sot Ipeshkëv titullar i Lestronës dhe Ndihmës i së njëjtës Kryedioqezë.

Kështu njofton zyra e shtypit e Selisë së Shenjtë.

Hapet, kështu, një faqe e re në historinë e Kishës së kryedioqezës metropolitane të Tiranë-Durrësit me shpalljen e kryepeshkvit të tretët, të periudhës pas rënies së diktaturës komuniste, të kësaj Kisha vendore, emëruar sot më 30 nëntor 2021 nga Papa Françesku.

Njoftimi i emërimit u shpall sot në mesditë në Katedralen e Shën Palit në Tiranë nga Nunci Apostolik në Shqipëri, imzot Luigi Bonazzi, në prani të kryepeshkvit të Tiranë-Durrësit Imzot George Frendo dhe të kryepeshkvit të ri të sapoemëruar Imzot Arjan Dodaj, me pjesëmarrjen e klerit e rregulltarëve të Kishës dioqezane Tiranë-Durrës. Ceremonia e njoftimit të emërimit të kryepeshkvit të ri imzot Arjan Dodaj u transmetuar drejtpërdrejt në streaming.

Data e përzurimit a fillimit të misionit të kryepeshkvit të ri të emëruar imzot Arjan Dodaj në Kishën kryedioqezane të Tiranë-Durrësit do të jetë të shtunën më 22 janar të ardhshëm.

Papa Françesku emëroi sot imzot Arjan Dodajn, kryepeshkëv të ri të kryedioqezës së Tiranë-Durrësit, deri më sot, ipeshkëv ndihmës i kësaj kryedioqeze metropolitane, emëruar nga Papa Françesku më 9 prill 2020, shuguruar ipeshkëv nga imzot George Frendo më 15 shtator 2020, në Kishën Katedrale të Shën Palit Apostull, në Tiranë. Imzot Dodaj është kryepeshkëv i tretë i Tiranë-Durrësit në periudhën pas rënies së komunizmit, pasardhës i imzot Rrok Mirditës dhe i imzot George Frendos.

Kryepeshkëv i ri, imzot Arjan Dodaj, rregulltar i ‘Vëllazërisë meshtarake të Bijve të Kryqit’, lindi në Laç të Kurbinut më 21 janar 1977. Në vitin 1993, pasi përfundoi shkollën e mesme në qytetin e lindjes, emigroi në Itali. U vendos në Cuneo, ku nisi të punojë. Më 2007 kërkoi të pranohej në ‘Vëllazërinë Meshtarake të Bijve të Kryqit’, pranë Bashkësisë “Shtëpia e Marisë”, në Romë. Në rrugën e përgatitjes për meshtari, nisi studimet e filozofisë e të teologjisë pranë Universitetit Papnor “Mbretëresha e Apostujve” ku mori tit-



ullin e Bakalaureatit.

U shugurua meshtar më 11 maj 2003 nga Papa Gjon Pali II, në Bazilikën e Shën Pjetrit dhe u inkardinua në kryedioqezën e Romës, si anëtar i 'Vëllazërisë meshtarake të Bijve të Kryqit', në bashkësinë "Shtëpia e Marisë".

Pas shugurimit meshtarak kreu detyra të ndryshme baritore. Nga 2003 deri më 2004 ishte zëvendës-famullitar në Famullinë "Shën Domenico Guzman", në Romë; nga 2004 deri më 2005, Zëvendës-Rektor i Rektorisë së "San Giovanni della Malva" dhe Kapelan i bashkësisë shqiptare në Romë; nga 2005 deri më 2017, zëvendës famullitar i Famullisë "Shën Rafaeli Kryeengjëll", në Romë.

Më 2017, me miratimin e ipeshkvit të vet, Kardinalit-Mëkëmbës të Shenjtërisë së Tij për kryedioqezën e Romës, u transferua si meshtar "fidei donum" në kryedioqezën e Tiranë-Durrësit, ku kreu këto detyra baritore: Vikar i përgjithshëm, Famullitar i famullisë "Zemra e Papërlyer e Zojës Mbretëreshë" në Gramëz; Drejtues i baritorisë universitare; Sekretar i dytë i Konferencës Ipeshkvnore Shqiptare dhe sekretar i përgjithshëm i Sinodit dioqezan të Tiranës-Durrësit.

Kryepeshkvit të ri i urojme punë e

mision të mbarë, sipas motos ipeshkvnore që ka zgjedhur nga fjalët testament e dhuratë të Jezusit mbi Kryq "Ecce Mater tua!" ("Qe Nëna jote!"), që përkohet me festën e sotme të Zojës së Dhimbshme, nën hijen e Kryqit të Jezu Krishtit - e pranë Zembrës së Zojës!

Fjala përshëndetëse e Imzot Arjan Dodaj në shpalljen si Arqipeshkvi i ri Metropolitan i Tiranë-Durrës

Vëllezër e motra të dashur, në këtë ditë në të cilën bëhet publik emërimi im si Arqipeshkëv i kësaj Kisha të dashur në Tiranë-Durrës, dua t'iu përshëndes të gjithëve me fjalët me të cilat etërit tanë filonin festat e tyre, por që falë Zotit sot po rikthehet në takimet tona: **QOFTË LËVDUAR JEZU KRISHTI!**

Në këtë kohë të ardhjes në të cilën presim Jezusin Princin e Pagues, është në Pagen e Tij që përshëndes e falënderoj vëllazërisht Arqipeshkvin e dashur Imzot George Frendo, që në këto vite na ka udhëhequr në udhën e Ungjillit; bashkë me të përshëndes Nuncin Apostolik Imzot Luigi Bonazzi, i cili në këtë moment këtu në Katedralen tonë i jep zë Papa Françeskut, dhe vullnetit të Tij për Arqidioqezën tonë.

Në fakt veçanërisht Papa Françeskut i shkon e gjithë mirënjohja e thellë plot

dashuri për vëmendjen që ka ndaj Kishës sonë, të cilën ia beson angazhimit tim si bari. Zoti na njeh e më njeh mirë në brishtësitë dhe kufizimet njerëzore, por në jetën time gjithmonë e më shumë kam njohur dhe kam besim në mëshirën Hyjnore: e për këtë dua të them me psalmistin "Do të këndoj për amshim Mëshirën e Zotit" (Ps. 88,2)

Me këto fjalë dëshiroj t'iu përshëndes ju vëllezërit e mi në meshtari, që së bashku të jemi instrumente të mëshirës Hyjnore jo vetëm në kremtimet e sakramenteve, por akoma më shumë e me më shumë dedikim në veprat e mëshirës!

Përshëndes të gjitha motrat e Arqidioqezës sonë, që në mënyrë kaq të përkushtuar, e në të njëjtën kohë të heshur dhe diskrete, janë samaritani i mirë nëpërmjet misioneve të ndryshme që jetojnë.

Përshëndes çdo gjymtyrë që përbën trupin e kishës sonë këtu: lëvizjet kishtarë, laikët e angazhuar e të gjithë besimtarët, veçanërisht të rinjtë që banojnë në këtë Arqidioqezë! Të rinjtë janë një destinacion i veçantë i dashurisë së Jezusit, i cili din të ndezë për ta edhe në vendin tonë "shpresën që nuk zhgënjën" (Rom 5,5).

Data e sotme 30 Nëntori, na kujton festën e Shën Andreut Apostull, i thirruri i parë, që aq shumë kremtohet nga vëllezërit tanë Ortodoksë, dhe për këtë arsye ky emërim dëshiroj që të jetë ogur i mirë i vëllazërisë me ta. Shën Andrea në fakt gjithmonë ka qenë një urë lidhje midis lindjes dhe perëndimit, ashtu sikurse në fakt ka qenë gjithmonë vendi ynë. I besojmë ndërmjetësisë së Shën Andreut ecjen tonë Ekumenike, po ashtu bashkë dhe me vëllezërit tanë në Krishtin që janë Ungjillorët. Veçanërisht një përshëndetje i drejtoj komunitetit Mysliman dhe atij Bektashinj, sepse në harmoninë ndërftare që karakterizon vendin tonë, të jemi gjithmonë të angazhuar për ato vlera që na bashkojnë e që së bashku promovojmë. Tirana është një Metropolit plot gjallëri dhe sfida, të cilat kanë nevojë për përkushtimin e të gjithë aktorëve që e përbëjnë atë, për këtë arsye një lutje dhe kujtim i veçantë i shkon autoriteteve qeveritare qendrore dhe vendore sepse së bashku mund të jemi arsye shprese për popullin tonë!

Në këto ditë në të cilat po përgatitemi për festën e Zojës së Papërlyer dua të rinovoj aktin e përkushtimit tim, dhe me mua të gjithë Arqidioqezës sonë ndaj zembrës së papërlyer të Marisë: "Totus Tuus Maria". Nën mbrojtjen tënde Maria duam të mësojmë të duam, të shërbejmë e të shpallim Birin Tënd Jezusin! Amen

Papa Françesku: Martesa është gjë e bukur, duhet durim, por ia vlen



Në videon me njetin e qershorit, Papa Françesku kërkon lutje për të rinjtë, që përgatiten për martesë. Dashuria është **“Ëndrra e Zotit”** për ne, nënvizon Ati i Shenjtë.

“Ja vlen të rrezikosh”: pavarësisht se martesa është “udhëtim impenjativ, nganjëherë i vështirë, nganjëherë edhe konfliktual”, “të martohesh e ta ndash jetën me dikë është gjë e bukur”. Papa Françesku dëshiron t’i inkurajojë të rinjtë ta ndërmarrin këtë udhëtim “për gjithë jetën”, në të cilin ka një aspekt qendror: dhëndri dhe nusja nuk janë vetëm, sepse “Jezusi i shoqëron”. E Ati i Shenjtë ia kushton këtij argumenti pikërisht njetin e lutjes së qershorit, përhapur sot në gjithë botën përmes videomesazhit të publikuar nga Rrjeti Botëror i Lutjeve të Papës, në bashkëpunim me Dikasterin e Vatikanit për Laikët, Familjen dhe Jetën.

Martesa si thirrje e Zotit

“A është e vërtetë ajo, që thotë dikush, se të rinjtë nuk duan të martohen, veçanërisht në këto kohë të vështira?”, pyet Papa, i vetëdijshëm për problemet dhe ndërlikimet e lidhura edhe me pandeminë. “Martesa – thekson ai – nuk është vetëm akt shoqëror: është thirrje që vjen nga zemra, është vendim i vetëdijshëm për gjithë jetën e kërkon përgatitje të veçantë”. Për këtë arsye, është i rëndësishëm shoqërimi i çiftit nga ana e krejt bashkësisë së krishterë:

“Ju lutem mos e harroni kurrë! Zoti ka një ëndërr për ne, dashurinë, e na kërkon ta bëjmë tonën. Le ta bëjmë tonën dashurinë, që është ëndrra e Zotit. E, të lutemi për të rinjtë, që përgatiten për martesë me mbështetjen e bashkësisë së krishterë: që ata të rriten në dashuri, me bujari, besnikëri e durim. Sepse për të dashur duhet shumë durim. Por ia vlen”.

Viti i veçantë kushtuar familjes

Kjo video bën pjesë plotësisht në Vitin “Familja Amoris Laetitia”, shpallur nga Papa Françesku më 19 mars 2021, me temë “Dashuria familjare: thirrja dhe udha e shenjtërisë”. Bie pikërisht në 5-vjetorin e Nxitjes Apostolike “Amoris laetitia” dhe në 3-vjetorin “Gaudete et exsultate”. Shoqëron gjithashtu Vitin e Shën Jozefit, i cili do të zgjasë deri më 8 dhjetor.

Ulet numri i martesave, rritet ai i divorceve

Në njoftimin për shtyp, që zakonisht shoqëron videon, jepet një pasqyrë e gjendjes së martesave, në ditët e sotme. Sipas statistikave, niveli i martesave ka rënë ndjeshëm që nga viti 1972, deri në atë pikë sa në vende si SHBA-të, është arritur niveli më i ulët që kur kanë filluar të mbahen regjistrat për këtë qëllim. Në shumë vende, është rritur moshja e martesës, me pasojë në lindjen e fëmijëve. “Përsa u përket familjeve, – nënvizohet në dokument – vihet re jo vetëm se përqindja e fëmijëve të lindur jashtë martese është rritur ndjeshëm pothuajse në të gjitha vendet anëtare të Organizatës për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik, por edhe se numri i divorceve është shumëfishuar, e në disa vende përfshin më se gjysmën e çifteve”. Për këtë arsye, bëhet themelore përgatitja dhe shoqërimi i familjeve, edhe me lutje, siç kërkon Papa Françesku për muajin qershor. (radio vatikani)

VAJOSJA E TË SËMUNDURVE RITET E FUNDIT TË NJË KATOLIKU

“Jam i hutuar rreth ndryshimit midis Sakramentit të vajasjes së të sëmurëve dhe “riteve të fundit”. Kur kam qenë fëmij, ata ishin të njëjtë...”

(Një besimtarë i panjohur)



Mark K. Shkreli

Para Koncilit të Dytë të Vatikanit, vajasja e të sëmurëve dhe “ritet e fundit” kryheshin shpesh së bashku. Kishte një tendencë për të pritur sa më shumë, që të ishte e mundur dhe për t’i kremtuar këto rite në prag të vdekjes.

Reformat e Vatikanit II, bëjnë përpjekje për t’i ndarë ritet që lidhen me sëmundjen dhe vdekjen dhe për të dalluar vajasjen e të sëmurëve nga ritet e kohës së vdekjes.

Në hyrjen e ritit të vajasjes së të sëmurëve thuhet: “Sakramenti i vajasjes është sakramenti i duhur për ata të krishterë, shëndeti i të cilëve është dëmtuar rëndë nga sëmundja ose



pleqëria” (Nr. 97). Më tej thuhet: “Prifti duhet të sigurojë që abuzimi me vonesën e marrjes së sakramentit të mos ndodhë dhe që kremtimi të bëhet ndërkohë që i sëmuri është në gjendje të marrë pjesë aktive” dhe “që ata që kanë nevojë për sakramentin duhet të kërkojnë në fillim të një sëmundjeje të rëndë” (Nr. 99).

Natyrisht, çdo fe ka zakone dhe tradita të ndryshme, në lidhje me trajtimin e vdekjes dhe kur njeriu është në pragun e saj.

Përsa i përket Kishës Katolike, qëllimi i Riteve të Fundit është t’i ofrojë pastrimin përfundimtar të shpirtit të personit, që është duke vdekur dhe ta përgatisë atë shpirtërisht për të hyrë në Mbretërinë e Qiellit.

Në Kishën Katolike, sakramentet janë shtatë: Pagëzimi, Krezmimi, Kungimi, Rrëfimi (Pajtimi), Vajimi, Urdhëri shenjt dhe Kurora e martesës.

Ato ndahen në tri grupe: Sakramentet e hyrjes (Nismetarë): Pagëzimi, Krezmimi

dhe Kungimi Sakramentet e shërit: Rrëfimi (Pajtimi) dhe Vajimi, Sakramentet e shërbimit: Urdhëri shenjt dhe Kurora e martesës.

Kur flasim për ritet e fundit, ne kryesisht i referohemi Vajasjes, por ky sakrament nuk shihet më si riti kryesor, por është një nga ritet e fundit: Vajasja e të sëmurit, Rrëfimi (Pajtimi) dhe Kungimi (Eukaristia).

Vajasja, i jepet personit në rast të një sëmundje të rëndë, kur ai ndodhet në prag të vdekjes, por edhe mund të përsëritet kur gjendja përkeqësohet ose paraqitet ndonjë sëmundje tjetër.

Sakramenti i Vajimit, sikur gjithë sakramentet, është themeluar nga vetë Jezu Krishti: “...duke derdhur këtë vaj mbi trupin tim, ajo e bëri atë që të më bëjë gati për varrim.” (Mt. 26:12). „Ajo bëri çka mundi: që më parë ma leu trupin tim për varrim”. (Mk. 14:8)

Që nga koha e apostujve, ata që i shërbenin komunitetit të krishterë nxiteshin të vendosnin duart mbi të sëmurët dhe t’i vajasnin.

“Është dikush ndër ju i sëmure? Le t’i thërrasë udhëheqësit e Kishës! Ata le të luten mbi të, duke e lyer me vaj në emër të Zotit” (Jak. 5:14-15).

Qëllimi i vajosjes, është të sjellë shërim. Më shpesh ky shërim është shpirtëror por, nëse është vullnesa e Zotit, mund të jetë edhe shërim fizik.

Katekizmi i Kishës Katolike thotë: “Eukaristia duhet të jetë gjithmonë sakramenti i fundit i udhëtimit tokësor, “viaticum” për “kalimin” në jetën e amshuar” (No. 1517).

Mënyra se si administrohen ritet e fundit ndryshon shumë në varësi të rrethanave dhe gjendjes të të sëmurit, nëse i sëmuri është në

gjendje të flasë apo jo dhe nëse është në gjendje të mirë me Kishën.

Kremtimi i *riteve të fundit*, për ata që janë afër vdekjes është *Viaticum*, hera e fundit që ai person merr Trupin dhe Gjakun e Krishtit.

Ky është një shërbim i veçantë eukaristik, që kremtohet afër kohës së vdekjes. *Viaticum*, mund të bëhet nga një prift, diakon ose një laik i trajnuar. Si pjesë e *riteve të fundit*, të sëmurit mund t’i ofrohet mundësia për pajtim (ose rrëfim), por vetëm nëse bëhet nga një prift.

Ritet e fundit, janë me shumë rëndësi për besimtarët katolikë, sepse këto janë lutjet dhe bekimet e fundit, që do të marrin përpara se të shkojnë në parajsë.

Administrimi i *riteve të fundit*,

është një pastrim përfundimtar, i cili përgatit shpirtin e të vdekurit të hyjnë në parajsë dhe jo në ferr, pasi ai i ka rrëfyer apo i ka rënë mohit dhe është penduar për mëkatet e tij.

Këto rite nuk bëjnë asgjë për të përgatitur trupin fizik të një të sëmuri, por përgatisin shpirtin e një katoliku në fill të vdekjes, duke e shfajësuar atë nga mëkatet, duke e bekuar me hir nëpërmjet vajosjes dhe duke marrë *kungimin përfundimtar* (*Viaticum*), që do të thotë “Me vete në udhëtim”.

Marrja e i riteve të fundit, është shumë me rëndësi për katolikët. Kush prej nesh do ta niste në udhëtim të afërmin e vet e mos ta porosiste të marrë me vete “strajcën e udhëtimit” - Viaticum!

Revista “Jeta Katolike” humbi anëtarin e Këshillit Botues, korrespondentin dhe ish Redaktorin LUIGJ KOLË ÇEKAJ

Më 5 janar 2021, revista “Jeta Katolike” humbi bashkëpunëtorin e vyer, anëtarin e Këshillit Botues dhe ish-Redaktorin e saj, shkrimtarin dhe Poetin, Luigj Kolë Çekaj. I njeri Luigj la pas bashkëshortën Violeta, djalin Terens dhe vajzat Enkolana e Justina. Redaksia e revistës “Jeta Katolike” i shpreh ngushëllimet familjes për bashkëshortin, babanë dhe vëllanë e saj të dashur. Luigji do të na mungojë shumë. Revista “Jeta Katolike” nuk do të jetë e njëjta pa punën e palodhshme të Luigjit. Jepja o Zot pushimin e pasosur, e i shndritë drita e pambarueme. Pushoftë në paqe.

Në zyrën tonë na kanë arritur një sërë shkrimesh nga kolegët dhe bashkëpunëtorët e Luigjit, por për shkak të kufizimeve të hapësirës ne nuk mund t’i publikojmë të gjitha. Këtu janë vetëm disa që i kemi zgjedhur.



LUIGJ ÇEKAJ – POETI I SHKRELIT TË MALËSISË SË MADHE

*“Libri juaj ka qenë një zbulim poetik për mua”
(Ismail Kadare)*



Frank Shkreli

Luigj Çekaj ndërroi jetë në fillim të këtij viti në moshën 70-vjeçare. Ai vinte nga Çek-Dedajt e Shkrelit të Malësisë së Madhe — fshati Bzhetë — nga e ka origjinën edhe familja ime. “Në Shkrel te shtëpia e prindërve të mij”, është një ndër poezitë e Luigjit, dedikuar vendlindjes. Atje, ku *“Te muri në vend të lahutës, bimë vjerrëse varen. Atje ku pijej buka, tani zogu ndjen uri.”*

Kur ishte në moshën 2-vjeçare, babai i Luigjit, Kolë Gjoka Çekaj, për t’i shpëtuar përndjekjes nga diktatura komuniste dhe dënimit me vdekje, arratiset në ish-Jugosllavi, në rrethin e Ulqinit, të cilin si bashkvendas që ishte, familja ime e strehoi për një kohë të gjatë dhe u kujdes për të derisa ai vendosi të emigronte në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Si biri i një të arratisuri, i mituri Luigj Çekaj jetoi ashtu me dhimbje, me njollën absurde të të prekurit dhe të përndjekurit, politikisht. Merrni me mendë, prej 2 vjeç, poeti i ardhëshëm do të jetonte nën tmerrin e persekutimit të diktaturës komuniste e që, eventualisht, shkoi edhe deri në arrestimin e tij. Në moshën 2-vjeçare kishte humbur babain, i cili u arratis për pikëpamjet e tija anti-komuniste. Pastaj, siç ka shkruar poeti Gjekë Marinaj në parathënjën e librit me poezi të autorit Luigj Çekaj, “Vjeshta

në Aeroporte”, se ndërkaq, Luigji i vogël kishte humbur edhe duart e së ëmës në pranga sepse kishte refuzuar të padiste të shoqin tek policia.

“Për herë të parë e të fundit në moshën dy vjeç më arrestuan.

Si natën e pushkatimit të Lorkës adoleshencë e hënës

Stoli të papërsëritshme në kujtesën



time ngeli,

shkëlqimi i prangave në duart e nenës! (Kujtim nga Fëminia, 1964)

Luigji i vogël, si 2-vjeçar dhe më vonë, po humbte gjithçka. Poeti i ardhëshëm me trupin e tij të njomë, humbi edhe vendlindjen më në fund, duke përfunduar në kampet e Tepelenës, si përfundim i vendimeve të autoriteteve komuniste. Kryeredaktori i gazetës Dielli, organ i Federatës Pan-Shqiptare Vatra, Z. Dalip Greca në parathënjën e librit të Luigjit, “Unë vij nga Shkodra”, ka shkruar, “Babai i Luigjit, për t’i shpëtuar kurthvdekjes

kishte kapërcyer kufirin, ndërsa familja shkonte për t’u kryqzuar. Hakmarrja u zbraz mbi gruan e pambrojtur të Kolë Çekaj, e cila do të plasej në birucat e ftohta. **Ç’mund të mbetej në kujtesën e një fëmije 2-vjeçar, që provonte burgun në moshën e lodrave? ...”.**

Ndërsa pyetja ime drejtuar nostalgjikëve të sotëm të regjimit të Enver Hoxhës — të cilët na thonë se, “komunizmi ka qenë në anën e duhur të historisë”, ose “komunizmi ka berë më shumë të mira se të këqia” — është se çfarë kërcënimi paraqiste për regjimin enverist 2-vjeçari Luigj Çekaj në vitin 1952, poeti i ardhëshëm i Malësisë? Si mund të mbrohet dhe të justifikohet një regjim i tillë edhe sot në Shqipëri 30-vjet gjoja post-komunizëm, në një vend anëtar të NATO-s, i cili pretendon gjithashtu edhe antarësimin në Bashkimin Evropian? Pse, ende 30-vjet pas ndryshimit të sistemit, nuk ka një distancim zyrtar nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës, i cili i hidhte fëmijt 2-vjeçar, si Luigj Çekaj dhe të moshave të tjera të mitura, në kampe përqendrimi, shumë prej të cilëve kanë gjetur vdekjen atje? Pse kjo heshtje zyrtare! Deri kur?

Për hir të Madhit Zot, ashtu i njollosur për jetë, si bir i një të arratisuri nga “parajsa” komuniste e Enver Hoxhës, Luigj Çekaj mbijetoi disi kampet, burgjet dhe diskriminimet komuniste gjatë gjithë jetës së tij — mbijetoi edhe “Shtëninë e dhimbjes”:

“Në prill të ’75-sës — Përrjashtim nga Universiteti

Në Maj vjen urdhëri — Të pushohet nga puna

Dhe në Qershor –Të dëbohet nga qyteti...”

Luigj Çekaj, gjithmonë e kishte pasion letërsinë por mundësia për të botuar iu dha vetëm pas ndryshimit të sistemeve në Shqipëri. Kështuqë, menjëherë pas ndryshimit të atmosferës politike, në vitet 1991-1993, ai filloi të kontribonte si redaktor i poezisë në gazetën e pavaruar, “Besa” në Shkodër. Pas kësaj, ai vendosë të largohej, përfundimisht, nga vendlindja dhe shkon në Amerikë si emigrant politik, për tu bashkuar me babain e tij, Kolë Gjokën. Luigj Çekaj vendoset në Bronx të Nju Jorkut, ku jetonte dhe babai i tij. Me të ardhur në Amerikë, gjatë viteve 1994-1998, ai angazhohet me revistën “Trojet tona”, ndërsa më vonë iu bashkua kolegjiutit të revistës “Jeta Katolike Shqiptare”, organ i Kishës Katolike Shqiptare, “Zoja e Shkodrës” në Hartsdale të shtetit Nju Jork. Në vazhdim të veprimtarisë së tij letrare në Nju Jork, ku jetoi familjarisht sa ishte gjallë, Luigj Çekaj ka botuar librat: “Vjeshta në aeroporte”, poezi, 1998 dhe “Unë vij nga Shkodra” në vitin 2004 — “Libri që renkon nga dhimbja” — ku ka përmbledhur mbresat e kujtimet e tija nga jeta në Shqipërinë komuniste dhe në Amerikën e lirë e demokratike. “S’na kontrolluan si të dyshimtë rojet,

*Bile as pasaportën s’na e nxuri kush me gojë!
Ne që sa herë shpirtin na e pruri në fyt
Sigurimi i dreqit në Velipojë*

*(Ditën e Hyrjes sime në Washington, 2
Prill, 1993)*

Më kujtohet se kur ishte i angazhuar pranë revistës, “Jeta Katolike Shqiptare”, unë banojsha në Washington, por me anë të një letre më kërkonte mendimin tim — si një ish anëtar i redaksisë së kësaj reviste që isha në fillim të 1970-ave — për ndryshimet që kishte bërë në formatin dhe përmbajtjen e revistës “Jeta Katolike Shqiptare”, në përgjithësi.

Me letrën në fjalë, Luigji më kishte dërguar edhe dy tre numra të revistës “Jeta Katolike Shqiptare”, të redaktuar prej tij dhe më kërkonte mendimin tim për formatin e ri të saj. Në pamje të parë, revista kishte



ndryshuar për më mire, falë angazhimit të Luigjit dhe ketë e kisha pasqyruar në përgjigjen time, ku ndër të tjera i kam shkruar: “Të them të vërtetën, duke u bazuar në shikimin e vetëm disa numrave të revistës që kam lexuar deri tani, më vjen shumë mirë që rifilloi botimi i saj. Për më tepër, u kënaqa se revista e re, “Jeta Katolike Shqiptare”, nën drejtimin tëndë është shumë e rindërtuar, më e mirë, më e këndshme dhe e lezetëshme për syrin, në krahasim me formatin e vjetër të revistës — një përmirësim i dukshëm, pra, si nga formati ashtu edhe nga përmbajtja. Ju dëshiroj suksese të mëtejshme.”

Për ringjalljen e revistës “Jeta Katolike Shqiptare” aty nga mesi i 1990-ave, një meritë e madhe i shkon Luigj Çekajt dhe bashkpuntorëve me

të cilët punoi në atë kohë në redaktimin dhe botimin e kësaj reviste, duke ia rritur vlerën si një organ serioz që pasqyron jo vetëm veprimtarinë e Kishës Zoja e Shkodrës por edhe të komunitetit më të gjërë shqiptaro-amerikan në Nju Jork dhe rrethe. Më vonë, poeti dhe shkrimtari i Shkrelit të Malësisë së Madhe, Luigj Çekaj është angazhuar edhe pranë Shoqatës së Shkrimtarëve dhe Artistëve Shqiptarë në Amerikë, ndërsa për një kohë ka shërbyer edhe si sekretar i kësaj shoqate intelektualësh shqiptaro-amerikanë. Luigj Çekaj është shquar dhe vlerësuar nga komuniteti i intelektualëve shqiptaro-amerikanë si një kontribues i vyer ndaj kulturës shqiptare në Amerikë dhe më gjërë. Por jo vetëm nga shqiptaro-amerikanët.

Veprat e Luigj Çekajt kishin renë në dorë të shkrimtarit të madh Ismail Kadare, i cili ka vlerësuar librin e parë të Luigjit me poezi, “Vjeshta në Aeroporte”. Në një letër dërguar poetit malësor nga Parisi, Z. Kadare ka vlerësuar me këto fjalë poezinë e tij: **“Libri juaj ka qenë një zbulim poetik për mua. Së pari për nivelin e tij poetik dinjitoz, e pastaj për rezinjatën me të cilën ju dëshmoni për kalvarin tuaj... Ju flisni për dhembjen me fisnikëri, sepse dhembja njerëzore nuk e përjashton kurrë fisnikërinë. Kumti juaj në këtë rast, qoftë artistik, qoftë ai moral, ka një peshë të dyfishtë”**, thuhet në letrën e Kadaresë, dërguar poetit Luigj Çekaj, me datën 28 nëntor, 1998.

Në veprat e tija Luigji shpreh, njëkohësisht, dhimbjet dhe dashurinë, së pari për nenën e vet të shumë vuajtur, për Shkodrën e tij të dashur, *“Në qytetin e Nju Jorkut, unë vij nga Shkodra, i pezmatuar”* dhe për dashurinë e tij për Shqipërinë:

*“Shqipëri, asgjë në botë veç nënës,
Nuk kam dashur më shumë se ty.*

*Ti me frymën tënde më ke kthyer në qenie ajri,
Ti me duart e tua më ke bërë njeri,
Gjërat unë i ndjej thellë në shpirt.”*

(Motivi për Shqipërinë)

Por në veprat e tija shfaqen edhe ndjenjat për Amerikën, ku më në fund gjeti strehimin, por edhe liri e pak paqë të merituar, më në fund. “Mes Shqiptarëve të Nju Jorkut, sigurisht”, shkruan Luigji, përfshir ne që na konsideronte si kushërinjtë e tij nga Bzheta e Shkrelit të Malësisë së Madhe që ishim vendosur në Amerikë dekada më parë e të cilëve poeti e shkrimtari u kushton atyre një artikull të gjatë, “Dy fjalë të mira edhe për kushërinjtë e mi të mirë”. Në librin, “Unë vij nga Shkodra”, ai përmendë pothuaj të gjithë ne emër për emër, ndërsa ka kujtuar takimin e parë me secilin prej nesh në Amerikë duke shënuar mbresat që i kishim lenë atij në takimin e parë me të. “Me kushëririn Fran Shkrelin u pash me hënë të mirë, sy për sy dhe shpirt për shpirt”, shkruan Luigji në librin e tij, “Unë vij nga Shkodra”. “Biseda me Franin atë mbrëmje shkoi vërtetë shumë mirë. Pothuajse gjithmonë ramë në një hulli të këthjelltë mendimesh të përafërta! Nuk patëm në asnjë rast mosmarrëveshje të çastit, apo kundërshtime të mirëfillta arsyetimesh të kundërta, madje aty rreth orëve të mesnatës kur darka mbaroi dhe erdhi koha të ndaheshim me Fran Shkrelin, unë më shumë se me një kushëri, u ndava si me një mik timin të kahershëm”, ka kujtuar Luigj Çekaj takimin tonë të parë në Amerikë.

Gjatë gjithë asaj bisede në takimin e parë me të, më kujtohet se me qëllim – duke mos dashur të hapja plagët e vjetra të vuajtjeve të tija e të familjes — nuk e pyeta asgjë për të kaluarën e tij dhe, sidomos, për vuajtjet e nënes së tij dhe familjes në Shqipëri, pasi pak a shumë e dinim situatën e përgjithshme nepër të cilën kishin kaluar ata dhe të tjerë si ata, që kishin ndonjë të afërm

të familjes të arratisur në Amerikë. Por gjatë atij takimi të parë me mua, as ai vet nuk deshi të fliste për vuajtjet e tija dhe të familjes së tij në Shqipërinë komuniste. Por, duke u ndarë me Luigjin atë natë, ashtu siç shënon ai në



librin e tij, unë nuk u durova pa i thenë: “Ju sonte nuk më folët asgjë të përveçme për të kaluarën tuaj personale në Shqipëri, deshta me thënë për kalvarin e gjatë të dhimbjeve tuaja të pambarimta. Ma merr mendja se bërë mirë që nuk fole, i thashë, se i di të gjitha dhe se intelektualët e një vendi nuk janë nëna fëmijësh jetimë që kujtojnë e zgjidhin hallet e veta me të qara...”.

Vërtetë, i tillë ishte poeti e shkrimtari Luigj Çekaj, kurrë nuk ankohej për vuajtjet dhe kalvarin e gjatë nepër të cilin kishte kaluar ai dhe familja e tij nën regjimin diktatorial të Enver Hoxhës, as nuk ankohej për gjëndjen jo aq të mirë shëndetësore, as për sëmundjen e rëndë që më në fund i mori jetën, në moshën 70-vjeçare, në fillim të këtij viti, në Nju Jork të Shteteve të Bashkuara. Profesori i ndjerë, Agron Fico, në një shkrim vlerësues kushtuar poetit Luigj Çekaj — botuar vite më parë — pasi ka vlerësuar meritat letrare të veprës së tij, është shprehur më së miri për ndjenjat njerëzore të shprehura në

veprat e Luigj Çekaj: **“Luigj Çekaj është poet i fuqishëm lirik, është kryepoet që, edhe pse trajton kalvarin dhe dramën e vuajtjeve dhe persekutimeve të familjes dhe të brezit të vet, në thelb dëshmon për ndjenja të thella humane të dashurisë njerëzore dhe shoqërore. Lirika e poetit Luigj Çekaj është meditative, përsiatjet janë jo thjesht nocione publicistike – politike, por darë dhe çekanë ndaj regjimit të pashpirt, të egër, regjimit totalitar-komunist: “Statujat e diktatorëve nuk qëndrojnë mbi piedestale. Ato janë ngulur si shpata në gjokset e njerëzve të pafaj”, “Statujat e diktatorëve.”**

Luigj Çekaj simpatizohej nga të gjithë, pa dallim, me të cilët ai vinte në kontakt: për sjelljet e tija prej një zotërie të vërtetë, për fisnikërinë e natyrës së tij prej malësori, si dhe për njerëzinë dhe çiltërinë e përzemërt, duke bërë shumë miq këtu në Shtetet e Bashkuara, shqiptaro-amerikanë nga të gjitha trojet shqiptare. Me jetën plot vuatje të rënda dhe me veprat e tija të vlerësuar nga intelektualët e dalluar shqiptaro-amerikanë me të cilët bashkpunoj ngusht pas arritjes së tij në Amerikë — por edhe nga shkrimtarë të mëdhej të Kombit si Ismail Kadare — Luigj Çekaj si njeri, si poet e shkrimtar — nderoi gjithashtu veten dhe familjen e tij të ngushtë dhe më të gjerë. Shkreli dhe Malësia e Madhe janë krenarë me të, ndërsa komuniteti shqiptaro-amerikan është përgjithmonë mirënjohës për kontributin e tij të vyer që ka dhënë për aq pak vite sa jetoi dhe punoi në gjirin e komunitetit tonë këtu në Shtetet e Bashkuara para se, fatkeqësisht, sëmundja t’ia shkurtonte jetën, parakohësisht, në fillim të këtij viti.

Lamtumirë poeti penëndritur Luigj Çekaj!

Keze Kozeta Zylo

Nuk kam shkruar gjatë gjithë jetës sime dhe t'i përcjellë publikut kaq shumë homazhe sa viti që shkoi dhe po aq gllabërues po duket dhe ky fillim viti...

Sot është ndarë nga jeta poeti penëndritur Luigj Çekaj. Lajmin e dhimbshëm e dha në llogarinë e saj në F/B, vajza e tij Enkolana Çekaj Mundija. Me trishtim dhe keqardhje të madhe e prita këtë lajm të ndarjes së parakohshme të Luigjit mikut tonë të perbashket për të cilin kishim një respekt reciprok nga më njerëzorët. Kur ngushëlluam të bijen dhimbja të kaplonte shpirtin, kur tha që ju donte dhe ju respektonte shumë të dy me Qemalin. Natyrshëm të vinë kujtime dhe komente pafund për shkrimet dhe poezitë, përvojat tona artistike që shkembenim midis. Poeti Luigj Çekaj është anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro Amerikan e cila humbi një poet të mirënjohur, kurse Diaspora një atdhetar zemërzjarr.

Dritë të pastë shpirti poeti penëndritur Luigj Çekaj!

Si homazh po sjellë pranë jush essenë time kushtuar poetit brilant Luigj Çekaj

Poezia e Luigj Çekaj një hartë me metafora plagësh...

Pasi me ta mbusha sarkofagët, vjeshtat dhe lumenjtë


Nxorra sytë nga vendi dhe vendosa t'i hedh në det

Bota nënujore me lashtësinë e

shkruar në shtrat

Me sytë e mi sfidoi thellësinë e ujit të vet...

(Nga poezia "Me lotët e popullit tim" fq.102)



Kam kohë që lexoj poetin Luigj Çekaj, ish të vuajturin nga diktatura, por jo në kohën e akullt kur dritën mbyllnin nën gur mortit...

I lexoj sot nën urën e dhimbjeve të emigrantëve që lëkundet në Oqean midis Shqipërisë dhe Amerikës. Vetëtimat zhuritëse e mohimit nën diktaturë nuk munda dot t'ju zhveshë atyre fisnikërinë si poet dhe njerëz, edhe pse mbi shpinë të tyre rëndon pesha e vuajtjeve dhe e mundimeve si guri i Sifizit.

Ndonëse kanë kaluar 22 vjet nga rënia e diktaturës është e çuditshme se si këtyre poetëve të persekutuar dhe burgosur më parë nuk iu kushtohet vëmendje e merituar anipse poeti Çekaj rilindi në Amerikë...

Poezite e tij të shkruara brenda qelive pus të zi të burgjeve, apo nën një Hënë të përgjakur nga hanxhari i një gardiani, medoemos bëhen si gjoksi i Rozafës së murrosur që la amanet për të ushqyer fëmijët. Ndryshe çmimdhënësit i lënë poetët siç do të shprehet Çekaj në poezinë "Justinës"

Kryet si qyqe shkoj dhe i mbështes tek vrasësi im i vjetër. De-pre-si-o-ni.

Ai shkruan me një butësi Bible për nënën e tij të shtrenjtë dhe kjo ndodh shpesh me poetë të kësaj race dhe ja se si:

Kur ti erdhe nga Shqipëria/ Besoja se as vdekjet nuk do të mund të na ndanin më/ si as distancat/ Ndërsa pranë teje kam celuloren me dyqind fotografi/ Një dosje dhimbjesh në ermin tim/ Që më kujton prangat/ si dhe tre a katër stilokalema...

Këtë lidhje aq të ngushtë nënë e bir e bën dhe më hyjnore poeti bir që qan dhe e puth, dhe dy pikëlzat e lotit të tij varen si rruaza argjendi në qafën e bukur dhe të rrudhosur të nënës halleshumë.

Duke lexuar ndjen se poeti i burgosur i ka shkruar me lotin blu të Hënës vargjet dhe i ka stamposur brenda trupit ku me siguri kishte fshehur fletoren poetike të shpirtit.

Ai i shkruante natën në muret e ftohta të dhomës së burgut ku metafora bëhej zjarri i ngrohtë, ndërsa qerpikët e rënduar nga lodhja bënin roje për të ruajtur legjendat që shkruheshin në libërthin e zemrës.

Libërthi u bë si një dritëz ylli, violinë Apostulli, një legjendë që do të tregohet gjatë... Autori shpesh duket dhe një romantik i kohës plot kulturë dhe mirësi dhe ja si e përshkruan bukurinë e një vajze meksikane: Balli i saj paksa i verdhë, dukej si një shpatullëz hënë/ ku si dy pellgje të kaltër yjesh, i shkëlqenin fort dy sytë/ Ngado që ta shikoje/ dukej se ishte meksikane/ por një meksikane e çuditshme, që sfidonte dhe mrekullitë. Me këto vargje Çekaj të kujton ciganen e bukur të Frederica Garsia Lorkës i cili u frymëzua prej saj dhe ja se si: "O mjellmë e zeshkët që noton në një liqen/ Me lotuse të rritura, me valë të portokallta/ Me karafila të kuq, ku shkulma kundërmon/ Foletë e roitura që ti mban nën flatra/ Martire andaluze, grua e mbetur beronjë/ Ç'janë puthjet e përflakura ti s'e di/ Puthjet e përziera me heshtje të thellë

nate/ Dhe me zhurmën e turbullt të ujit që rri”.

Pena e tij nxjerrë nga gjoksi nimfat e bukura, perëndeshat e bukurisë që emocionojnë me ndjesi të holla si filigramet e artizanëve të punuara në shekuj aq mjeshtërisht në poezinë “Trëndafilat e Majamit”. “Sapo i pashë këta trëndafila m’u kujtuan buzët e tua të kuqe/ Kopshtet erotike të Shkodrës dhe gjetet jeshile të tulipanit/ Tani dhe shpirti im i lodhur belbëzon dalëngadalë emrin”...

E bukura tërheq kudo e për më tepër një poet si Çekaj që prek ylberet permallimthi në qerpiqet e bukur të vashave. Poeti aty ndërton folezën e dashurisë hyjnore, i cili i jep një dritëz të re botës dhe ndez flakën e dashurisë aq të munguar. Poezitë e tij kanë mbirë natyrshëm si një ngushëllim për shpresë, ato janë filiza të një aristokrati të poezisë dhe bëhen model qytetarie të një poezie në perfeksion.

Vargjet e tij më duket sikur më sjellin pranë Ana Ahmatovën ku nobelisti Brodcki thotë se rigjeti gjuhën e ligjëritimit në universin shurdhmemec.

Në dhuratën me librat e tij që më dërgoi midis të tjerave në dedikim më shkruante se: “Lorka e quan poezinë thjesht si...”Një drer të plagosur”, kurse unë vazhdon poeti me një modesti për t’u pasur zili, vjershat e mia dosido do t’i quaja “si një Njeri i plagosur” duke e zëvendësuar me artin e zëvendësimit fjalën dreri me njeri ...

Ashtu si dreri me sy të magjishëm dhe vështrim të butë që shetit pranë pemëve dhe ul kokën për të pirë ujë, buzë një pellgu a liqeni të pastër plagoset pafajësisht nga gjahtarët, ashtu më duket dhe poeti, zemra e të cilit u plagos pafajësisht nga gardianët e dhjamosur që zbatonin urdhërat e diktaturës verbërisht.

Diçitura e shkruar me një shkrim të bukur kaligrafik do të ruhet gjatë dhe me krenari në arshivën time personale dhe ndërkohë të kujton poetin tjetër hyjnor Frederik Rreshpjen me poezinë vdekjen e Dedelit të cilit varrin ja bënë në aerodromin e qiellit, ndërsa Zeusin

modern e mallkoi. Poezite e Çekaj janë si një far që fshehin shkëndijëza brenda metaforave të tyre me një ngarkesë të theksuar emocionale plot gazavaje që prekin thellë zemrat e lexuesve të shumtë.

Shokët e burgut të tij janë dhimbja e madhe e poetit. Një prej poezive kushtuar bashkëvuajtesve është ish të burgosurit politik “Luigj Kabashit” të cilët kanë lindur në një qytet me disidentë të rebeluar si metaforat e Selman Ruzhdiut, ku plagët e viktimitave s’ka mundur asnjë pushtet t’i shërojë, mjerisht...

“Me Luigjin, dashtë pa dashtë/
Kam patur një si fat absurd/ Sepse kur
Ai shpresonte të dilte jashtë/ Unë
trëmbesha se do të hyja në burg”/

Në poezitë e tij ngrihen probleme të mprehta sociale dhe shoqërore që po kalon shoqëria jonë. Kështu hapja e dosjeve me të cilët spekullojnë shumë nga parlamentarët tanë ai shkruan: “Hapeni shtatoren/ o ushtarë që të shoh/ Shkodrën dhe time motër...” Dhe krejt si në historinë e njëres nga ato me telefaks ma dërgoni urgjent “Dosjen”. Dhe nxini ku të mundni/ Bëjeni sterrë deri në fund/...Se me “dosjen” time të bardhë, Kam ndërmend të bëj biznes, Në blefsha atje njëqind dollarë, Dy milion këtu do e shes...”

Ato pikojnë dhe trokasin mendueshëm mbi shpirtrat tanë, mbi shpirtrat e lexuesve, por nuk jam e sigurtë, se sa ndihen ndër shpirtra ligjvënësish??

Poezitë e Çekaj janë vatër e prushtë me thëngjij ndezur. Ai bisedon poetikisht me shkrimtarë të shquar i ka ftuar për darkë në tryezën e tij dhe ndjen dhimbje për njerëzit e papërgjegjshëm që gjejnë lloj lloj mënyrash për të hedhur baltë mbi punën e tyre dhe ja se si: “Parmbrëmë, Noli me Konicën qenë për darkë tek unë, Të dy nervoz, sepse i shanin në Internet edhe pas vdekjes!... Kurse Millosh Gjergj Nikolla/ Me një penë të ngulur në gjoks! I tundur më tha: Atdheu im m’u ankua! Tashti duket se

s’ka më nevojë për mua!”

Marrë nga poezia “Shpirtrat e Shqiptarëve më duken si Ata të purgatorëve”, fq.34.

Poeti ndjen dhimbje gjer në eshtë për përbaltjen që iu bëhet burrave të ndritur të Kombit, apo vuajtjet e tmerrshme që pësoi kjo klasë fisnikësh, ndaj ai lutet duke thënë në poezinë: “Le të jem unë shpirti i fundit/ Që po gërryhem/ Nga tërë ky përrua gjaku/ Sajuar për zhdukjen e popullit tim. Marrë nga poezia “Le të jem unë” fq.25

Duke përfunduar poezitë e Çekaj pashë dhe preka nga afër një hartë me metafora plagësh, ku pena e tij siç dhe shprehet është një lufte poetike, është hartë e dhimbshme plagësh vizatuar me thika hijesh mbi shpinë...

POETIT LUIGJ KOL ÇEKAJ

-Lezhë, 1998.-

Më gëzove o shkreljan, me poezitë e tua,
Sinqerisht për ty po jem krenar,
Për ato vargje mjeshtrore që ke shkrua,
Si shkrelas dhe si shqyphtar.

Malësia e Madhe të ka birin e vet,
Atje në atë famshmen Amerikë,
Vazhdo dhe shkruaj me mereqep,
Për Atdheun tend që të ka rritë.

Jo për fame, e jo për emën
Por për Shqypni që e do aq shumë,
E kanë me të dashtë penën!
Sa duhet drita e pa fund!

Unë si Vrrithjan e si Shkrelas të uroj
Ec nëpër vargje me guxim,
Gdhënde poezinë kësisoj,
Sikurse e ke skalit në këtë vëllim. (*)

Gjeto Turmalaj.
Lezhë, 1998.

(*) *Asht fjala për librin me poezi
“Vjeshta në Aeroporte”*

SHENJTËRIT E ULPIANËS

“Kosova e sotme apo Dardania Antike, ishte vend i shenjtë dhe vendi më kompakt në planin nacional, gjuhësor dhe fetar, dhe shquhej në gjithë Ilirinë dhe më gjerë. Këtu i kemi martirët e parë të krishterimit, Shën Florin dhe Shën Laurin, gjatë viteve 117-135 pas Krishtit.”

Ky është konstatimi më i bukur i brumosur me një vetëdije dhe përgjegjësi të lartë për kulturën e stërlashtë të popul-



Don Fatmir Koliqi

lit tonë, i thënë prej një burrështetasi shembull, që tregonte lidhjen e pashkëputur të historisë së shenjtë të

Dardanisë/Kosovës mijëra vjeçare. Janë pak rreshta, por të artë, që e rikthejnë shikimin te rrënjët, themelet, shtyllat autoktone mbi të cilat ne sot i bëjmë hapat tanë në shekullin XXI. Njëkohësisht, është grishje për zgjim të ndershëm të kujtesës së shenjtë – *memoria sancta* – në mënyrë që t’i japim jetë të tashmes dhe ta bëjmë të ardhmen pa frikë identitare (në votrën e kontinentit). Është i vetmi burrështetas dhe prej të paktëve intelektual të vërtetë, që e ka pasur këtë vetëdije të lartë, dhe këtë e ka bërë mision kulturor dhe politik, si çuarje në vend të “testamentit” të stërgjyshërve për ta dashur e për ta mbrojtur të patjetërsueshme këtë tokë të martirizuar.


Në këtë histori të shenjtë dardane, vendin e parë e zënë, me të drejtë, dy vëllezërit binjak **Shën Flori** dhe **Shën**

Lauri, martirë, që konsiderohen vula, monedha dalluese e krishterimit tonë, të cilët e kanë dëshmuar me gjak fenë e tyre në Krishtin.

Martiologu Romak ditëfestën liturgjike të tyre e vendos më 18 gusht, që në Kishën Katolike është *ditëlindja për qiell (dies natalis)*.

Për jetën dhe veprimtarinë e tyre kemi të dhëna të pakta, siç ngjan për shumë martirë e shenjtër të kësaj epoke, posaçërisht të trevave tona, për faktin e mbretërimit të kohërave të kobshme, të vështira dhe për humbjet e shumta që janë bërë për atë periudhë.

Materialet e *Acta Martyrum* (shq. aktet e martirëve), *Acta Sanctorum* (shq. aktet e shenjtërve) dhe burimet hagiografike që janë përdorur deri më tani për të krijuar një jetëshkrim të



Harta e Dardanisë



Qyteti Antik i Ulpianes (kryeqyteti i Dardanisë)



përafërt të tyre kanë kryesisht proveniencë bizantine apo ndikim bizantin, siç janë *Sinassari Konstantinopolitan*, *Mentologjitë*, dhe disa dorëshkrime që ruhen në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit, 141 (shek X); *Vat. Gr. 1671* (shek X) dhe *Vat. gr. 821* (shek XI-XII).

Sipas këtyre dokumenteve Shën Flori dhe Lauri ishin vëllezër binjak që kanë pësuar martirizimin në kohën e perandorit Hadrian (c. 117-138), me profesion gurgdhendës (skulptor), nxënës të Prokulit dhe Maksimit, martirë. Pasi këta të fundit u martirizuan për Hyjin, nxënësit e tyre Flori dhe Lauri erdhën nga Bizanti (Konstantinopoja) në Ulpianën e Dardanisë në Iliri dhe atje punuan në një gurore pretoriane pranë Likonit, qeveritar/administrator i vendit. Farlati i radhit të katërtit, do me thënë edhe Prokulin dhe Maksimin, si martirë dardanë. Koha e jetës dhe e martirizimit të tyre, karakterizohet me rritjen e klimës armiqësore ndaj të krishterëve në Pjesën Lindore të Perandorisë Romake (Bizanti) edhe në Iliri, ku persekutoheshin mizorisht.

Dokumentet na rrëfejnë se Likoni e kishte marrë një letër-kërkesë nga njëfarë Licini, biri i perandoreshës Elpidia, qeveritar në rajon, në disa vende i quajtur edhe si prokonsull, me anë të cilës i kërkohej që t'i dërgonte dy

vëllezërit mjeshtër për të ndërtuar një tempull. Gjatë periudhës së ndërtimit të tempullit Flori dhe Lauri kishin marrë famë të madhe, si te qeveritarët, po ashtu edhe te populli i thjeshtë, sepse ata punën e kryenin profesionalisht dhe me nder, kurse në anën tjetër, me të ardhurat e mira që i fitonin nga puna e mjeshtërisë së tyre, ndihmonin të varfrit e vendit, tek të cilët gëzonin zë shenjtërie.

Tempulli u punua dhe u krye me mjeshtri të rrallë, sa që kishte nxitë mahnitje nga punëdhënësi Licini. Madje gjatë ndërtimit ndodhi edhe një mrekulli që ishte bërë prej shenjtërve binjakë: Anastasi i biri i një prifti pagan me emrin Merentini, ndërsa ishte i pranishëm në punimet e tempullit, një cifël guri kërceu dhe i hyri sy. Kjo ngjarje kishte sjellë një rrezik të madhe për dy vëllezërit duke i akuzuar nga i ati se ata po i mbysin punëtorët dhe po sillnin zi në vend. Porse, Flori dhe Lauri, pasi u luten, e shëruan mrekullisht, madje arritën edhe ta kthenin në fenë e krishterë, së bashku me të atin.

Para se të bëhej inaugurimi i këtij tempulli nga Licini, siç ishte zakoni në botën perandorake, ku organizoheshin festa e dëfrime karakteristike, vetë Flori dhe Lauri e organizuan një procesion me të varfrit dhe punëtorët e krishterë që i kishin, hyjnë në tempull dhe i largojnë të gjithë idhujt pagan dhe vendosin kryqin që përcillet me këngë lavdi, himne e psalme drejtuar Krishtit, Zotit të tyre! Kur dëgjoji Licini për këtë akt, dha urdhër që të arrestoheshin të gjithë dhe të dënoheshin pa mëshirë. Të varfëritë dhe punëtorët e krishterë i dogji të gjallë, ndërsa Florin e Laurin i arrestoi, dhe pasi bëri një proces hetues vendosi t'i vriste me një vdekje edhe më mizore se të parën: i hodhi në një pus të thellë për së gjalli.

Besimtarët e krishterë shkonin në vendin ku pësuan martirizimin dhe luteshin ndërmjetësisht të tyre, sepse i mbanin të shenjtë që e dhuruan jetën për Krishtin dhe si të tillë mund të nxjerrin hire prej Hyjit për t'u përngjarë në jetë dhe në dëshmi, gjatë persekutimeve të rënda që ushtroheshin mbi ta. Pasi kohët ishin të vështira dhe të pasigurta në raport me të krishterët dhe kultin e tyre ndaj shenjtërve martirë, bashkësia e krishterë u kujdes që eshtrat e tyre të bartën në një vend të sigurt dhe pastaj, sipas të gjitha gjasave, pas lirisë së fesë, përkatësisht pas Ediktit të Milanos, në vitin 313, me të cilin Konstantini i Madh ia jep lirinë e shpalljes krishterimit në të gjithë Perandorinë, reliktet e Shën Florit e Laurit vendosen në Kishën e Manastirit të Shpëtimtarit të Gjithëpushtetshmit (*Pantocrator*), në afërsi të Kishës së Filipit apostull, në Konstantinopojë, Stambolli i sotëm.

Kulti ndaj tyre mori dhenë në të gjithë Bizantin deri vendet e largëta të Rusisë, Skandinavisë e Italisë, ku janë kushtuar kisha, vepra arti, janë emëruar qytete (San Floro në Catanzaro të Italisë), Tolstoji i përmend në veprën e tij monumentale "Lufta e Paqja". Ikonografia dhe arti i shenjtë në përgjithësi, që nga lashtësia, i paraqet si dy skulptorë

mjeshtër dhe shembull të shenjtërisë në arte e punë skulpturore.

Në Ulpianën Antike dhe në trojet përreth në Dardani, pas martirizimit të Shenjtëve, persekutimit të krishterimit në përmasa të mëdha nga Perandoria Romake, erdhi koha e lirisë së fesë, gjatë së cilës do ta bëjë këtë vend ndër më të rëndësishmit të krishterimit të hershëm. Në shek. III dhe IV ajo do të quhet *Municipum Ulpiana splendissima*, (shq. Qyteti madhështore i Ulpianës) për madhështinë që e barte si qytet i pasur, përmes të cilit kalonin rrugët më të rëndësishme të rajonit, dhe do të themelohet ipeshkvia e Ulpianës, priftin/ipeshkvin e të cilës e gjejmë, të nënshkruar në afekt e Koncilit të Sordikës në vitin 342, si



Monedhë Dardane (Dardanici)

“*Machedonius a Dardania de Ulpianis*”. Por kjo gjendje e madhërishtme, fatkeqësisht, nuk do të zgjasë shumë dhe Ulpiana do të përjetojë një termet të fuqishëm (c shek. IV) që e rrafshoi përdhë, Justiniani do ta rindërtojë qytetin e ri e do ta quaj me emrin *Justiniana Secunda*. Përkundër emrit të ri të qytetit, ipeshkvi vazhdoi ta mbajë emrin i Ulpianës (*episcopus Ulpianensis*). Më vonë, në Dardani del në skenë ipeshkvia e Prizrenit, një qytet tjetër i rëndësishëm për krishterimin tonë. Në shekujt e mëvonshëm Ulpiana me rajonin pësoi një martirizim të përmasave pushtuese, shkatërruese e transformuese nga sllavët ardhaçak. Me gjithë këto, Ulpiana do të mbetet gjithnjë në analet e Kishës Katolike si seli titullare që asnjëherë nuk u shua deri në ditët e sotme. Përkundrazi, Selia e Shenjtë në rrethanat e reja që janë krijuar sot, i jep këtij rajoni kishtar dinjitetin e ipeshkvisë së re, me një gërshetim të dy qyteteve historike dardane, duke e emnuë Ipeshkvia Prizren-Prishtinë (2018), pa e shuar Ipeshkvinë titullare të Ulpianës antike. Në këtë mënyrë, gjaku i martirëve të Ulpianës lidh epokat duke nxjerr filiza të rinj nga fara e mbjellë shekullore te pasardhësit e tyre shqiptarë, që kanë banuar në trekëndëshin *Scupi/Shkup– Ulpiana/Prishtinë– Priscensi/Prizren*.

Edhe ky realitet i ri kishtar, që është ripohuar me vendimin e ri të Selisë së Shenjtë, i kuptuar si vazhdimësi e natyrshme fetare dhe nacionale, na e sjell te një përfundim i pranueshëm që duhet të merret në konsideratë në raport me Shenjtërit e Ulpianës.

Edhe pse pothuajse të gjithë hagiografët, që nuk janë

të shumtë, në mënyrë të tërthortë prejardhjen e tyre e vendosin diku në territorin e Bizantit, përkatësisht të Konstantinopojës, me qëllim për t'i identifikuar me botën/ritin greko-lindor, megjithatë shenjtërit e Ulpianës Flori dhe Lauri, duhet të kenë prejardhjen diku në trojet e Ilirisë, nëse jo në Dardani, edhe pse i udhëhequr apo i administruar prej Perandorisë Romake të Lindjes, ku ka pasur një dominim të ritit latin katolik apo latinitetit romak. Këtë hipotezë e bazoj në etimologjinë e emrave të tyre latin dhe të vetë Ulpianës Antike të Dardanisë, në të cilën arkeologjia e derisotme gjatë gërmimeve ka zbuluar artefakte e shkrime në latinisht. Ky fakt, duhet të hapë pista të reja kërkimi për të gjetur, nëse jo vendin e tyre të lindjes, së paku territorin e përafërt të prejardhjes, që duhet të jetë me proveniencë ilire-latine. Pra përjasja hulumtuese duhet ketë kahe tjetër, për dallim nga ato që janë bërë deri më tash. Burimet, pra, duhet të rishikohen, për të zbuluar elemente të reja, që do të pasuronin njohuritë për Shenjtorët e Ulpianës e të vendosen në truallin e tyre të origjinës.

Shenjtërit e Ulpianës tregojnë për pasurinë e paraardhësve tanë dardanë, se ata nuk kanë lindur vetëm burra e gra luftëtarë, veprat e të cilëve numërohen në historiografinë kombëtare dhe ndërkombëtare, nuk është vetëm territor i pasur me xehe e toka të pëlleshme, me plot bukuri natyrore, vendtakimi i kulturave dhe ndërlidhja rruqore e popujve, por ajo ka lindur dhe ka rritur njerëz të shenjtë, që rrinë në themelet e kulturës dhe qytetërimit tonë.

Pikërisht në këtë perspektive, në Ulpianën tonë antike është e shkruar e skalitur në shkëmb feja e stërgjyshërve, aty kemi themelet e arkeologjisë së krishterë, aty është e gdhendur teologjia, kisha e stërgjyshërve, aty prekim praninë e tyre të syrgjynosur, kulturën e krishterimit apostolik, që është trashëguar ndër shekuj nëpërmjet Burimit të Pagëzimit – Pagëzimoren tetëkëndore, vendpagëzimin e popullit tonë, është shpallur e edukuar në bazilikat e stilit romanik, tempujt tanë shpirtëror, duke e bashkuar popullin tonë në shtegtimin mijërvjeçar krishtenor. Pra, Ulpiana e jonë del të jetë foleja e shpalljes së Krishtit Zot, Shpëtimtarit të njerëzimit, votra e dëshmisë së shenjtëve!

Ky qytet i shenjtë është i larë me gjakun e martirëve dardanë Shën Florit e Laurit dhe shokët e tyre të shumtë. Edhe sot në gërmadhat arkeologjike ata nuk pushojnë të na flasin dhe na grishin për ta gdhendur ndërgjegjen tonë me virtytet e fesë, me qëllim të ripërtëritjes së kulturës sonë krishterë, e cila ka brumosur në vazhdimësi palcën e identitetit tonë dardan-arbëror-shqiptar. Ky vend dhe shenjtërit e tij, na thonë se guximi i pranimi të identitetit autokton është cilësi e shenjtëve dhe njerëzve të ndershëm!

Shenjtërit (për)bëjnë një ind të veçantë shpirtëror/shoqëror, të aftë të rigjenerojnë ndërlidhje konkrete mes kohërave, periudhave, gjeneratave të

njerëzve dhe t'i mbushin zemrat e tyre me një energji ripërtëritëse dhe përbashkuese, pasi "Shenjtërit dhe shenjtëreshat gjithmonë kanë qenë burim e zanafillë ripërtëritjeje në rrethanat më të vështira gjatë historisë së Kishës." (Gjon Pali II, *Christofele laici*, nr. 16).

Ndërlidhja/indi e bartë në vetvete edhe simbolin e qëndresës dhe të sigurisë për vazhdimësi në të ardhmen. *Kush e ndërton të ardhmen me shpirtin e shenjtëve ai ndërton në shkëmb, në tokë të sigurt, që vërshimet e shekullit nuk mund ta tundin as ta rrënojnë!*

Shën Flori dhe Shën Lauri qëndrojnë si dy shandan ndriçues për t'i dhënë dritë Kishës dhe këtyre trojeve, vendit tonë, e na thërrasin të kemi gëzimin e të qenit të mbështjellë me vallon e krishterimit, në një vend të mbuluar me injorancën, indiferentizmin dhe harresën për përkatësinë e stërlashtë

Janë si dy lule erëmirë që e mbushin këtë hapësirë me aromën e fesë të stërgjyshërve tanë e nuk vyshken kurrë. Por si farë e mbjellë në tokë, qesin filiza të rinj për të dhuruar aromën hyjnore në çdo stinë, në çdo kohë.

Ata janë si shtyllat bartëse të Kishës që nuk e lënë të rrëzohet. Edhe sot në gërmadhat e shtrira në rrafshinat e "tokës grabitur", ata mbesin shtylla të shpirtit dhe të identitetit të rrënjët.

Ata ndonëse nuk nderohen nga shumica e të vetëve, e pasardhësve të kësaj toke, disa nga mosdija e disa nga mohimi i vetëdijshëm, megjithatë ata mbesin figura autoktone, të lashta, të shenjta dhe dëshmi e krishterimit apostolik të Dardanisë së Shenjtë, që ndër shekuj nuk ka pushuar ta lajë me gjak vendin e vet, për të dëshmuar kulturën e dashurisë së krishterë, vlerat njerëzore.

Shenjtërit e Ulpianës janë burrat e dëshmisë krishtenore ndër paraardhësit tanë dardanë, vula e krishterimit apostolik dhe lashtësia jonë!

Shenjtërit e Ulpianës na thërrasin për të ushqyer kujtesën, për të jetuar me kujtesën për ta bërë të gjallë dhe reale kujtesën!

Një popull pa shenjtër është një popull i varfër shpirtërisht! Shoqëria që nuk inspirohet prej jetës së martirëve dhe të shenjtëve, vuan nga mungesa e kulturës shpirtërore.

Krishterimi e ka kultivuar kulturën e shenjtëve dhe shenjtëreshave, nderimin e tyre, si modele të njerëzve të ndershëm, me parime e virtyte njerëzore që prodhojnë qytetërim dhe shpesh për të ardhmen.

Vendi ynë që nga lashtësia konsiderohet vend i shenjtëve, i dëshmoreve e dëshmitarëve, prandaj edhe me të drejtë është quajtur *Dardania Sacra* – Dardania e Shenjtë, sepse ajo është e mbushur përplot me shenjtër dhe shenjtëresha, që ia kanë kushtuar jetën Zotit dhe popullit, me kushtime të përshpirtshme dhe me gjakun tyre.

Europa ka në themelet e veta Shenjtërit (shih shkrimin "Mjeshtri i Kulturës Europiane"), etërit e kontinentit që me

shenjtërinë e tyre i kanë dhënë jetë një kulture që ne sot e jetojmë, e gëzojmë ndonëse ka prej atyre që e mohojnë dhe e braktisin, madje-madje edhe e luftojnë.

Në këtë kuptim kultura e shenjtërisë është shenjë e qytetërimit të një populli. Popull ynë, që prej kur mbahet mend, ka nxjerrë nga gjiri i saj shenjtër e shenjtëresha – të fundit shenjtëreshën e madhe Shën Nënë Terezën dhe martirët e komunizmit – është popull me një qytetërim të lartë të krishterë që meriton të radhitet në vargun e qytetërimit evropian.

Ulpiana si trashëgimi qëndron në piedestalin historik-kulturor dhe shpirtëror i Kosovës, si kujtesë, si dëshmi dhe si inspirim për çdo gjeneratë.

Sikur në kohën e Shën Florit dhe Laurit kur ishte e rëndësishme të shpallehin virtytet e fesë, edhe sot është më se e rëndësishme të ripërtërihen këto virtyte përtej çdo ideologjie religjioze apo instrumentalizimi të tyre. Dëshmia e shenjtëve e ka fuqinë për të ndryshuar historinë e për të dhënë dritë aty ku errësira e mëkatit dhe kompromiset ideologjike e vyshkur identitetin e vërtetë të kombit e të fesë. Po, kjo dëshmi e tyre ringjall shpirtin e dashurisë ungjillore kundrejt vaktësisë shpirtërore të brendshme dhe të jashtme. Për këtë arsye, ne sot kemi nevojë për shenjtër, si modele, për të rizgjuar ndërgjegjen e fjetur dhe për të ripërtërirë zemrat e besimtarëve për një entuziazëm dhe gëzim të fesë, që të vendoset në qendër personi i Jezu Krishtit, dhe që kultura e njeriut dhe e shoqërisë të ketë aromë ungjillore për ta krijuar qytetërimin e dashurisë.

Kosova sot ka nevojë urgjente për një shpirt profetik, për shenjtër që e rizgjojnë kushtimin për jetën, vlerat, atd-hedashurinë e pastër, kushtimin për të mirën e përgjithshme, kultivimin e respektit, vëllazërisë dhe të paqes mes popujve, e të shtrijë këtë shpirt më tej, në një rajon ku luftërat ndëretnike dhe lakmia për pushtet mbi të tjerët e ka lodhur ndër shekuj deri në ditët tona. Sot, me një shikim të singertë në retrospektivë dhe me një shikim shpresëbartës në perspektivë, ungjilli mund të jetë shëruesi i plagëve shekullore të popujve, që mbi këto plagë të ndërtohet kultura dhe qytetërimi i dashurisë, që dhuron lumturinë e secilit.

E Shën Flori dhe Shën Lauri, shenjtërit e Ulpianës, janë dy lule erëmirë, që mund të frymëzojnë këtë gjakim të munguar, që të shtrihet aroma e dashurisë së Krishtit si urim dhe përgëzim për qytetarët e vendit tonë.

drita.info

(Pjesë nga libri në botim, "Kulturë e krishterë. Dromca identitare, Drita, Prishtinë 2021, f. 57-69).3

Literatura:

Pavle Mjović, *Flor i Lavr-neimari i kamenoresci iz Ulpiane, GKM, nr.VII-VIII (1962-1963), Prishtinë 1964.*

Illyricum Sacrum, vol. VIII (Daniele Farlati; Jacopo Coleti): *Ecclesia Scopiensis, Sardicensis, Marcianopolitana, Achridensis et Ternobensis cum earum suffraganeis*, Venetiis, 1819,

Don Gaspër Gjini, *Ipushkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, Drita, Prizren 2011.

Antonio Bressi, *I santi Floro e Lauro*, Grafica C –Napoli, 1998.

Gjon Pali II, Nxitja apostolike post-sinodale *Christofefeles laici*, Arqipeshkvia Shkodër-Pult, Shkodër 2008.

Ibrahim Rugova, pjesë nga fjalimi me rastin e bekimit të gurthemelit të Katedrales Shën Nënë Tereza në Prishtinë, 26 gusht 2005.

Martyrologium Romanum ad diem 18 augusti: “*In Illyrico sanctorum Martyrum Flori et Lauri artis lapicidinae, qui, sub Licione Preaside, martyrio consumptis eorum magistris Proculo et Maximo, ambo, post multa tormenta, in profundum puteum funt demersi.*”

(shq. Në Iliri, shenjtërit martir Flori dhe Lauri, gurgdhendës, të cilët, pas martirizimit të mësueseve të tyre Prokulit dhe Maksimit, gjatë kohës së qeverisjes së Likonit, pas torturimeve të shumta, qenë hedhur të dytë në një pus të thellë). Marrë nga Don Gaspër Gjini, *Ipushkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, f. 62; khs. edhe A. Bessi, *I santi Floro e Lauro*, f. 84.

Pavle Mjović, *Flor i Lavr-neimari i kamenoresci iz Ulpiane*, GMKM, nr.VII-VIII (1964),140-141.

Illyricum Sacrum, vol. VIII (Daniele Farlati; Jacopo Coleti): *Ecclesia Scopiensis, Sardicensis, Marcianopolitana, Achridensis Et Ternobensis cum earum suffraganeis*, Venetiis, 1819, 2-3.

Hagjiograf, emër nga latinishtja e vonë *hagiographus*, që ka burimin tek emri gr. ἁγιογράφος, i cili është i përbërë nga ἅγιος – i shenjtë dhe γράφω – shkruar, jetëshkruar i shenjtërve, studiues i hagjiografisë. Është një formë jetëshkrimi e përdorur që nga Kisha në shekujt e parë e deri në ditët tona. Khs. zërin *agiografo*, në:

Janë dy emra tipik të botës latine. Emri *Florius-ii* – nga latinishtja e do të thotë *lule*, shqip mund të përkthehet me emrin Lul, Lulëzim, Flori, kurse versioni femëror *Flora* – Lule, Luljeta..., po ashtu edhe *Flora* tek shqiptarët katolikë. Latinët e kanë përdorur këtë emër për formën e urimit, që e lidhnin me hyjninë e pranverës, luleve dhe vegjetimit. Kurse emri *Laurus- i*, po ashtu është emër latin dhe do të thotë dafinë, lar. Te shqiptarët katolikë emri mashkullor Laur është shumë i përhapur, kurse versioni femëror Dafina (prej mitologjisë gr. *daphne*) nuk ka konotime religjioze dhe është i përdorur nga të gjithë shqiptarët pa marrë parasysh përkatësinë fetare. Laura është bimë aromatike gjithnjë e gjelbër nga familja *Laureaceae* e përhapur kryesisht në Mesdhe, prandaj edhe në trojet tona bregdetare. Vjen nga familja e *Laurus nobilis* – që do të përkthehet në dafina fisnike, versioni i jugut, kurse lari fisnik versioni i veriut. Në kohë të lashta është përdorur për të simbolizuar fitoren: përdorej për të kurorëzuar fitoret e betejave, njerëzve të kulturës, artit dhe të shkencës. Nuk di të ketë emra të këtillë në botën greko-helene, e si rrjedhojë të krishterimi lindor, që do të mund të vendoseshin këta në atë hapësirë. Ky element etimologjik dhe kulturor i kohës na shtyt të mendojmë për përkatësinë e tyre ilire, nëse jo dardane.



Nënë Tereza: Vetëm për gra të veçanta

Mos harro se lëkura rrudhet,
e flokët mbulohen me borë;
Ditët bëhen vite...
por më e rëndësishmja
nuk ndryshon kurrë!
Forca jote e bindja jote s'njohin moshë.
Shpirti yt e shtrin pëlthurën e merimangës
që mosha ta endi mbi fytyrë!
Pas çdo pikarritje, ka një pikënisje.
Pas çdo suksese, një zhgënjim.
Përderisa je gjallë, gjallëro!
Në qoftë se të mungon çka bëje më parë,
bëje përsëri,
mos rri duke parë fotografi
të zverdhura nga koha!
Mos e lerë të ndryshket hekuri
që ke brenda vetes.
Sillu në mënyrë që, në vend të mëshirës,
të gëzosh respekt.
Kur të rëndojnë vitet e s'mundesh më të vraposh,
ec shpejt.
Kur s'do të mundesh as të ecësh shpejt,
ec!
E kur as të ecësh s' do të mundesh,
përdore shkopin e shko....
Veç për t'u ndalë,
ti kurrë mos ndalo!

(Nënë Tereza)

Festa e Shën Markut, autorit të Ungjillit më të lashtë

Ungjilli i Markut u shkrua rreth vitit 70 pas vdekjes së Krishtit. Titullohej: "To Euaggelion" – "Lajmi i Mirë". Për bashkësitë e para të krishtera, Marku ishte 'hija', që ndiqte hap pas hapi shtegtimet e dy apostujve të mëdhenj: Palit të Tarsit e, më pas, Simon Pjetrit.

R.SH. - Vatikan

Më 25 prill, kalendari përkujton shën Markun ungjilltar. Ky shenjtë ungjilltar, Marku, me jetën dhe me veprën e tij na nxit t'ia kumtojmë vëllezërve lajmin e madh të shëlbimit, të ecim në gjurmët e apostujve, për të përhapur në të katër anët e botës Ungjillin, forcë që e shndërron gjithësinë e që provon praninë e Zotit ndërmjet njerëzve.

Shën Marku, ungjilltar, një pjesë të mirë të jetës e kaloi duke ndjekur e bashkëpunuar në veprimtarinë apostolike të apostujt kryesorë, Palit, të cilit i qe afër edhe gjatë burgimit, e pastaj si dishepull i Pjetrit, shkroi ungjillin e dytë, duke mbledhur predikimin e apostullit mbi të thënat e mbi faktet e Jezusit, shpalur Bir të Hyjit të dëftuar nga Ati Qiellor. Pastaj, si vdiq Pjetri, ishte ai që i priu veprimtarisë apostolike. Këtë na tregon tradita për Shën Markun, autor i Ungjillit më të lashtë, festën e të cilit e kremtoi sot Kisha katolike.

Është viti 64 pas Krishtit. Mbi një kodrinë të Romës, pranë Rugës Kornelia, që njëhej si Kodra e Vatikanit, zhvillohet një ngjarje tepër prekëse. Trupi i një njeriu të kryqëzuar varroset në një gropë të hapur në varrezën e vogël, pranë cirkut privat të Neronit, që ngrihet po në këtë kodrinë. Në arenën e këtij Cirku, pak orë më parë, ndërmjet gjamëve të hatashme të qindra të krishterëve të torturuar mizorisht, ka vdekur ai që solli në Romë lajmin e shëlbimit të Krishti: Simoni, i thirrur Pjetër, peshkatar nga Galileja.

Nuk është e vështirë të përfytyrojmë, në grupin që varros dëshmitarin e parë të Nazarenit, edhe praninë e një njeriu, një farë Gjoni, që njëhej me emrin Mark. Për të krishterët e parë Marku, prej kohe ndjekës i



Palit të Tarsit, është dishepulli të cilin Pjetri, në një letër të tij, e quan përzemërsisht 'biri im' (1 Pt. 5, 13). Marku është sekretar që di greqisht, që mund të shërbejë si përkthyes e, për më tepër, i njeh më mirë se të gjithë, mësimet gojore të Apostujve të parë. Papia i Gjerapolit, një nga ipeshkvijtë e parë të krishterë, kujton mësimet një farë "presbiteri" me emrin Gjon. Shkruan: "Marku, përkthyes i Pjetrit, shkroi gjithçka që kujtonte, si fjalët, ashtu edhe veprat e Zotit Jezus, pa i kushtuar kujdes rendit të ngjarjeve".

Por ky njeri, që vite me radhë jetoi nën hijen e kryetarit të Kishës së lindur në Jerusalem, ishte shumë më tepër se një kopist: ishte njëri nga të katër Ungjilltarët e Mëdhej, që na la trashëgim Ungjillin, i cili njihet me emrin e tij:


Krishtit. Titulli është To Euangelion, Lajmi i mirë. Kështu i pari nga të katër Ungjijtë, më i lashti, u bë realitet. Ai që të gjithë e pandehnin thjeshtë kopist, kishte krijuar një gjini krejt të re letrare. E edhe në se, në vijim, prototipi do të tejkalohet për stil, ndërtim e dendësi njoftimesh, nga Ungjijtë e tjerë kanonikë, gjithsesi në të ndjehet shija e predikimit të parë të krishterë.

Marku e shkroi për të krishterët me origjinë pagane, për t'iu përgjigjur pyetjes 'Kush është Jezusi?' e për të dhënë përgjigjen 'Jezusi është Mesia'. E Ungjilli i Markut arrin të na bindë plotësisht për këtë, posaçërisht kur na përshkruan fljimin e Krishtit në Kryq. Zëri i të krishterëve të rinj në Ungjillin e tij shprehet përmes mahnitjes së Çenturionit mbi

vepruar në Akuilea, në ato troje të lindjes italiane, me të cilat do të lidhej ngushtë emri i tij. Më pas i erdhi radha Aleksandrisë, apostulimit në Cirenë, gjë që e pasqyrojnë mrekullisht bukur disa nga pikturat e famshme të Tintoretos. Si kthehet në Aleksandri, edhe për Markun arrin ora e martirizimit.

Trupi i tij mbetet në këtë qytet deri në vitin 828, kur sundimtari arab vendos ta rrënojë shenjtëroren ku ruheshin reliket e Ungjilltarit, për t'i përdorur mermerin dhe shtyllat në ndërtimin e një pallati në Babiloni.

Nga frika e dhunimit të relikeve, dy tregtarë venedikas, Buono nga Malamoku dhe Rustiku nga Torçelo vendosën ta merrnin tinëz trupin e ungjilltarit e ta sillnin në Itali, të fshehur ndërmjet koshave, ku kishin shtënë der-



Basilika e Shën Markut në Venedik

Ungjilli i Shën Markut.

Pas vdekjes së Apostullit, Markun nis të shkruajë në mënyrë të rregullt tregimet e Pjetrit. E kryen librin e tij rreth vitit 70 pas

Kalvar, që thërret: "Vërtetë ky njeri ishte Biri i Hyjit!".

Në gjurmët e Pjetrit, Marku tani bëhet predikatar. Për disa kohë, së bashku me Pjetrin, pati jetuar e

rkucë, për të shmangur rrezikun e kontrollit nga ana e myslimanëve. Venediku do të bëhej, kështu, qyteti i Shën Markut!

Një requiem i vonuar për mikun dhe studiuesin e palodhur të kulturës dhe klerit katolik erudistin Kolec Çefën (1937-2021)

"Për herë të parë kam pasë fatin ta takoj në shoqërinë e at Zef Pllumit, andej nga viti 1991. E që atëherë e kam pa gjithnjë në shoqërinë e Françeskanëve të medhenj- e librave të tyre -botuem, por dhe të dorëshkruar -të françeskanëve të medhenj... Kontributi i tij në rivlerësimin e kulturës shqiptare është vërtetë i madh, duke qenë se mbetet një studiues skrupuloz, i vëmendshëm, i papërtuem, e mbi të gjitha, i përkushtuem me shpirt dhe zemër ndaj vlerave të kulturës kombëtare. Një provë se ishte gjithmonë me Zotin. Me dritën. Me mirësinë! I përulë me respekt të madh kujtimit të tij! Gjithmonë!" - Rudolf Marku, London, United Kingdom



Klajd Kapinova

Me vjen shumë keq, që e mora vonë, shumë vonë, lajmin e hidhur të kalimit në amshim të mikut dhe studiuesit të palodhur të kulturës dhe klerit katolik shqiptar erudistit Kolec Çefa.

Kjo për arsye të distancës së largët në SHBA, mungesës së informacionit nga Shqipëria, qyteti i lashtë Shkodrës dhe Tirana, ku ai shkoi për të jetuar më vonë.

Për Kolecin e kulturës dhe botës së letrave, studimeve dhe hedhjen dritë për figurat e pluhrosura dhe të përbalta të klerit katolik dhe Kishës martire shqiptare, ruaj kujtime shumë të bukura, mbasi kemi punuar bashkë për shumë vite, në Arqipeshkvinë Metropolitane, në zyrën e redaksisë së revistës të hershme popullore qytetare "Kumbona e së Dielës".

Kjo revistë u themelua dhe drejtua me kulturë dhe pasion fetarë dhe atdhetarë në fillim nga dom Mikel Koliqi (1900-1997), i cili pas kalvarit pambarim të vuajtjeve dhe burgjeve të tmerrshme komuniste do të shugurohet në Vatikan nga Ati i Shenjtë, sot shën Papa Gjon Pali II (Karol Wojtyła 1920-2005) si Kardinali i Parë, në të gjithë historinë e lavdishme 2021-vjeçare të Kishës Katolike Shqiptare, si simbol i respektimit nga bota, Kisha Katolike dhe Selia e Shenjtë në Vatikan, të vuajtjeve të të gjithë shqiptarëve, nën rregjimin e egër diktatorial ateisto-komunist.

Me Ndihmës Ipeshkvin e Arqipeshvisë së Shkodrës imzot Zef Simonin (1928-2009), shkrimtar dhe prozator i 15 librave të shkruar në gjuhën e ëmbël gegë, me profil fetarë dhe bazë të shëndoshë atdhetare, i

ndjeri mons. Zef Simoni, dhe kryeredaktorin studiuesin Kolec Çefa, kemi punuar vazhdimisht për të nxjerrë rregullisht nga shtypi të përkohshmen mujore revistën "Kumbona e së Dielës".

Ai ishte redaktori i kujdesëm i të gjithë librave të shkruar në gjuhën gegë nga shkrimtari imzot Zef Simoni, mbasi Koleci njihte shumë mirë dy dialektet e gjuhës shqipe gegë dhe toskë.

Koleci ishte i urtë, i ditur, i mençur me shpirt të madh fisniku

Intelektuali solid Kolec Çefa, me kulturën e thellë dhe të gjërë që zotëronte nga përvoja e njohjes nga afër të klerikëve dhe leximet e librave (në dorëshkrim) të shumtë të tyre dhe të tjera, ishte një enciklopedi e gjallë, që ecte me dy këmbë, duke mbajtur të freskët në mendje çdo ngjarje dhe figurë të qytetit tonë.

Nga ai kam mësuar shumë nga historia me tradita e qytetit, letërsia e gegë e trevave

të Veriut, pendat e spikatura dhe veçantinë e stilit të gjithsecilit prej tyre, figurat e shquara dhe kontributin e vijueshëm në fushën e cultures dhe historisë, atdhedashurisë, studimeve, albanologjisë etj., të Klerit Katolik në Shqipëri gjatë vitëve 1944-1991.

Shkrimtari monsinjor Zef Simoni, ishte drejtues i revistës "Kumbona e së Dielës", ndërsa kryeredaktor ishte Kolec Çefa dhe unë redaktor për shumë vite. Monsinjori e donte shumë Kolecin, për kulturën dhe shpirtin e madh prej një shkodrani të vërtetë. Koleci ishte zemër bujar dhe ndihmonte pa përtesë kedo që i shkante në redaksi për dokumente, këshilla, literaturë (libra), saktësimin e datave dhe ngjarjeve të ndryshme, rreth figurave të shquara të Klerit Katolik Shqiptar, buletinet e ndryshme apo të përkohshme të shtypit katolik të hershme dhe deri në ditët tona.



Klajd Kapinova, Dom Zef Simoni dhe Kolec Çefa

Gjermani albanolog dr. Markus W. E. Peters dhe Koleci ynë

Një ndër miqët tanë të vijueshëm ishte gjermani dr. Markus W. E. Peters, i cili, ishte i adhruar shumë mbas historisë dhe kulturës dhe histories së prelatëve të shquar të klerit katolik. Ai në mënyrë autodidakte kishte mësuar shumë mirë gjuhën e bukur shqipe, por njikohsisht fliste edhe shumë gjuhë të tjera ndërkombëtare.

Dr. Peters kërkonte literaturë, buletine të ndryshme të shtypit të klerit katolik, dokumente dhe dorëshkrime të lënë amanet nga prelatët dhe klerikët e Urdhërave të ndryshme katolike në qytetin e Shkodrës, Tiranë, Mirditë, Lezhë etj.

Ai shumë kohë e kalonte në Arkivin Qendror të Shtetit (AQSH) në Tiranë, duke shikuar me shumë kujdes në seksionin e dokumentave të Arqipeshkvisë së Shkodrës, të cilat komunistët kur erdhën në pushtet i grabitën nga Kuvendi i Urdhërit të Shën Françeskut (shekulli XII) dhe Kuvendi i Jezuitëve në Shkodër (1846).

Ai vinte shpesh së bashku me babain e tij dhe me orë të tëra bisedonim për tema të ndryshme në redaksinë tonë. Dr. Peter më vonë do të shugurohet meshtarë dhe do t'i përkushtohet udhës adhuese të Zotit, për t'i shëbyer grigjës në Gjermani, më pas në qytetin-shteti të vogël të Litenshteinit, dhe tani në Zicër, ku ai është bari shpirtërorë i besimtarëve katolikë.

Fryt i kësaj pune të gjatë hulumtuese, është edhe botimi me sukses i librit në gjuhën shqipe: **"Përballjet e Historisë së Kishës Katolike në Shqipëri 1919-1996"**, (Geschichte der Katholischen Kirche in Albanien 1919-1996) gjermanisht dhe shqip. Vepra e re ka autorësinë e studiuesit dhe albanologut bashkëkohorë gjerman **Dr. Don Markus. W. E. Peters**, botuar në kujdesin e Shoqatës Jezuite, Tiranë, 2010.

Albanologu gjerman dr. Markus W. E. Peters sot quhet **dr. Father Mark Peter ose Don Peter**. Ai vazhdimisht viziton SHBA dhe ndalon edhe në New York, për t'u takuar me miqët e tij të vjetër: *Don Nikolin Pergjigjin, studiuesin dhe publicistin Tomë Mrijaj dhe autorin e këtij shkrimi modest Klajd Kapinova.*

Vjedhja e të drejtave të autorit nga diktatura komuniste dhe shpërlarja e trurit me gënjeshtër sot

Diktatura komuniste dhe (Neo)komunistët edhe sot i kanë bërë si pronë shtetërore dhe kurrë nuk iu kthyen pronarëve të ligjshëm thesaret kulturore, që janë Kuvendi Françeskan dhe Jezuit.

Sikurse dihet publikisht ato me një pjesë të punimeve dhe hulumtimeve albanologjike të realizuar nga prelatët dhe



klerikët e thjeshtë të Urdhërit të Shën Françeskut ish "professor" dhe "doktorët" e "albanologjisë" së periudhës së komunizmit mbrojtën temat e tyre "shkencore", duke mos i përmendur asnjëherë emrin e tyre kjoftë edhe formalisht.

Ata në mënyrë të turpshme apo harbutshe nuk bënë asgjë tjetër veçse hoqën autorësinë origjinale të klerikëve katolikë dhe vendosën emrat e tyre.

Rasti më klasik është i ashtëquajtur "prof.dr." **Jup Kastrati**, i cili, asokohe ishte Kryetar i Grupit të Luftës Kundër Fesë dhe Zakoneve Prapanike, të krijuar nga diktatori Enver Hoxha si organizatë e mirëfilltë propagandistike kundër fesë, Kishës, prelatëve dhe meshtarëve të thjeshtë katolikë.

I përkdheluri i rregjimit komunist Jupi i ri asokohe me disa shokë të tij fanatikë, ka marrë në shtëpinë e vet (në kohën e bastisjeve të dhunshme me gjak dhe terror) shumë nga antikualet, disertacionet, dorëshkrimet dhe vlerat e tjera kulturore shkrimore, të bërë ndër shekuj nga studiuesit e shquar klerikë katolikë dhe disa katolikë intelektualë laik të spikatur të trevave të Veriut të Shqipërisë.

Dhe për t'u mos u zgjatur shumë, theksojmë se pseudo albanologut të Dullës, disa herë pas vitëve '90, i është bërë thirrje publike dhe private, që të rikthejë pronën e të përkutuarve politikë anti-komunistë intelektuale të klerikëve katolikë si e drejtë e tyre (Copyright), por ai me arrogancë e inercisë së (neo)komunizmit, që ende kishte dhe ka pushtet kudo edhe sot, dhe me paturpsi komuniste nuk ka marrë mundimin që t'i rikthejë, si shenjë pendimi për ato të këqija që u ka bërë atyre... Ato monumente brilante dhe të papërsëritshme intelektuale të kulturës kualitative albanologjike edhe sot gjenden në shtëpinë e tij private. Pasardhësit e tij heshtin, duke

mos dhënë asnjë shenjë pendese dhe keqardhje edhe sot në demokraci, mbas 32 vjetëve...

Për më tepër "Prof. dr." Jup Kastrati, shkruan me histerizëm dhe pasion anadollaku **Parathanjen** e librit me gënjeshtër dhe trillime të propaganduesit fanatik komunist Rakip Beqaj, me titull perves: **"Veprimtaria Antikombëtare e Klerit Katolik Shqiptar"**.

Mirëpo Jupi i sigurtë në shpifjet e tij, ndër të tjera thotë se:

"Vepra e shokut Rakip Beqja, **"Veprimtaria antikombëtare e klerit katolik shqiptar"**, asht e para e kësaj fare, që po botohet në vendin tonë. Libri ka randësi politike, ideologjike dhe shkencore...

Në disa paragrafë, auktori ban fjalë edhe për fenë, shikue në dritën e shkencës marksiste-leniniste, për shtetin e Vatikanit, për kishën katolike dhe kapitalet e saj.

Kjo hymje ishte e nevojshme për të kuptuar rranjë e thella historike të fesë katolike, e cila, në vendin tonë, gjithëmonë "ka qenë ideologji e pushtuesve romakë, italianë dhe austriakë" siç na mëson shoku Enver.

Kisha katolike ka veprue, gjithëherë, si shtypëse e çdo lëvizjeje përparimtare, demokratike, populllore. Ajo ka qenë vazhdimisht kundër mendimit të lirë. Ajo ka mbetë gjatë gjithë ekzistencës së saj, në pozita antikombëtare dhe reaksionare.

Auktori, me anë dokumentash dhe faktesh të pamohueshme, ka arritë të zbulojë degjenerimin dhe korrupsionin e klerit.

Në fund të kapitullit të parë, hartuesi i monografisë ban një përgjithësim me randësi, në lidhje me kishën katolike shqiptare, tue na tregue se ajo, në çdo kohë ka qenë e predispozue dhe e gatëshme të përdorë pozitën e vet politike për qellime të këqija, tradhëtare në shërbim të të huejvet, kundër interesave të Atdheut tonë.

Në kapitullin e dytë, auktori, mbasi shqyrton gjëndjen e Shqipnisë në prapen e pushtimit nga Italia fashiste si dhe gjëndjen ndërkombëtare në prapen e shpërthimit të luftës së dytë botnore, ndalohet tek roli i shtetit të Vatikanit.

Në mënyrë të veçantë ai sjell fakte konkrete, që dëshmojnë se si krenët e klerit katolik shqiptar kanë qenë gjithmonë në shërbim të të huejvet; kështu p.sh., nga 1870 deri në mbarimin e luftës së parë botnore u shërbyen austro-hungarezëve; gjatë periudhës 1919-1943 qenë në shërbim të italianëve; kurse, nga shtatori 1943 deri në çlirimin e Shqipnisë, 29 nandor 1944, qenë të lidhun kambë e krye me gjermanët nazistë.

Këto lidhje me të huejtë siç e spjegon bukur autori rrjedhin, së pari, nga fakti se këta agjentë të Vatikanit në Shqipni, gjithëherë, kanë përmbyshë detyrat, që u ka ngarkue ai; së dyti, sepse kleri katolik shqiptar ka pasë kurdoherë, të njejtja qellime politike dhe ideologjike me pushtuesit e huej.

Fondet e ndryshme, që u derdhën në vendin tonë nga Austro-Hungaria dhe Italia fashiste për

të mbajtë gjallë institucionet fetare sollën si rrjedhim, nënshtrimin pa kushte të klerit katolik ndaj pushtuesve imperialistë.

Ma anë dokumentash arkivale, autori i veprës tregon qartë dhe në mënyrë bindëse se si kleri katolik shqiptar punoi për pregatitjen e pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste.

Për të parën herë në botimet tona shkencore i bahet e njohun publikut të gjanë veprimtaria antikombëtare dhe reaksionare e njansës nga organizatat e klerit katolik shqiptar, pra "Veprimi Katolik" (Aksionit Katolik).

Në kapitullin e tretë auktori flet për pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste dhe për bashkëpunimin e klerit katolik shqiptar me pushtuesit.

Krerët e klerit katolik së bashku me tradhtarët e tjerë të vendit sanksionuen humbjen e pavarësisë së Shqipërisë...

Në këtë mënyrë mbyllet libri i parë i kësaj monografie. Për veprimtarinë reaksionare dhe antikombëtare të klerit katolik mbas çlirimit të Shqipërisë, gjatë pushtetit popullor, auktori do të hedhë në shtyp, së shpejti, librin e dytë...

Karakteristikë e përgjithshme e veprës që kemi në dorë, asht çfrytëzimi i një literature të gjanë, tue fillue nga veprat e klasikëve të marksizëm – leninizmit, tue vazhdu me materialet historike të Partisë së Punës së Shqipërisë si dhe raportet dhe fjalimet programatike të shokut Enver...

Tue u mbështetë në këtë bibliografi të gjanë, auktori ka ditë të interpretojë drejt ngjarjet dhe fenomenet, ka arritë të zbulojë rranjë të vjetra dhe të reja të veprimtarisë antikombëtare dhe reaksionare të klerit katolik.


Mbi bazën e një dokumentacioni të shumtë ka ba analizën e fakteve, ka nxjerrë konkluzionet e duhuna logjike, ka sqarue mjaft çështje të panjohuna nga publiku i gjanë. Në këtë drejtim, ai i ka sjellë një shërbim të vyer historisë së Shqipërisë...

Tue pasë për bazë "metodologjinë marksiste-leniniste, tue u mbështetë në metodën e materializmit dialektik dhe historik, auktori ka dërmue njëherë e përgjithmonë mitin e "patriotizmit" të klerit katolik, ka rrëzue tezat e absolutizueme nga disa historianë klerikë, në lidhje me të ashtuquejturën "veprimtari kombëtare" të klerit katolik.

Si rrjedhim, Rakip Beqja e ka shikue me sy kritik historiografinë klerikale të Shkodrës dhe asht ngritë me guxim kundër saj. Ka mbajtë qëndrim të patundun, të premë dhe parimor ndaj disa figurave klerikale, që në historinë e letërsisë shqipe janë quejtë "kontradiktore" ose "komplekse", si, bie fjala, shkrimtarit reaksionar Fishta.

Ky asht një qëndrim aktiv i studiuesit, i cili nuk asht vetëm hetues, gjurmues, përshkrues dhe regjistruer i faktit, por edhe interpretues i drejtë dhe i palëkundun i fenomenit.

Një tjetër vegori e veprës asht fakti se auktori ka vu, në radhë të parë, atë që asht kombëtare mbi atë krahinore. Ai mban qëndrim kritik ndaj



konseruatorizmit, partikularizmit, regionalizmit dhe ndaj çdo çfaqjeje regresive të së kaluemes.

Vepra tingëllon si një thupër e fortë ndaj autorëve të historisë kishitare shqiptare, që kishin idealizue dhe ba "idhuj të paprekshëm" disa krenë të klerit katolik. Vepra, që nga kreu e deri në fund, shquhet për frymën e thellë klasore.

Në vepër ndeshën dy botë: e reja me të vjetrën, rryma përparimtare me atë që asht reaksionare, fetare, prapanike, anakronike.

Në njenën anë, një vijë e kuqe spikatë në mbarë veprën: asht rruga e atdhetarëve të vërtetë, rryma e partisë, e komunistëve, e Luftës Nacional-Çlirimtare.

Kjo ka të ardhemen përpara, i përket së resë, asaj që asht përparimtare, progresive, demokratike, popullore; prandaj triumfon mbi të vjetrën.

Nga ana tjetër, një vijë e zezë bie në sy në veprimtarinë e klerit katolik shqiptar: asht vazhda e tradhtësisë, e falsitetit, e demagogjisë, vija e reaksionit ma të tërbuem, e antishqiptarizmit, e asaj që asht regresive, e mykun, e dalun boje; prandaj asht e destinueme të vdesë.

Asht siç provohet mjaft mirë në vepër, baza politike, ekonomike dhe ideologjike e klerit katolik në Shqipëri ka qenë, gjithmonë, e huej për botën shqiptare.

Tue iu referue materialeve të botueme nga vetë kleri, po sjellim këtë të dhanë historike, që dëshmon qartë se, pothuaj, të gjithë misionarët, organizatorët dhe krenët e klerit katolik në Shqipëri në shekujt e kaluar kanë qenë me kombësi të huej.

Mjafton t'u hedhim një sy françeskanëve dhe jezuitëve, tue mos u ndalue tek benediktinët e domenikanët.

Historikisht dëshmohet që në vitin 1248 Urdhëni françeskan filloi me u vendosë në Shqipëri, me zgjedhjen e françeskanit Giovanni de Plano Carpini arqipeshkëv i Tivarit. (2)

Ky prelat bani me ardhë në Shqipëri françeskanët dhe domenikanët, tue zevendsue, kështu, benediktinët, të cilët, që nga kjo kohë,

kishin fillue me braktisë manastirët e tyre.

Në veprën "Schizzo Storico sull'opera dei Francescani in Albania", asht dhanë lista e françeskanëve, që u zgjodhën peshkopë ndër dioqeze të ndryshme. Kështu, p.sh., në arkidioqezin e Tivarit dhe të Durrësit, në dioqezin e Shkodrës, Lezhës, Sapës, Pultit, Krujës, Sh'Shtjefnit (në Mat), Arbërit, Shazit, Bardhecit, Drishtit, Ulqinit, Shurdhahit, Sapës e Sardës, d.m.th. ndër dy arkidioqeze dhe trembdhjet dioqeze janë të regjistruem rreth 80 peshkopë të huej.

Çdo njeni nga këta ipeshkvoj ka sjellë në vendin tonë frymën e nënshtrimit ndaj politikës austriake dhe italiane. Me një ideologji të tillë u rritën dhe u edukuen edhe klerikët katolikë vendas.

Në kete temë historike, janë kapur ato periudha që për rëndësinë e tyre në saje të një studimi, analize e sinteze të thellë të ngjarjeve e fakteve mbi klerin katolik shqiptar, jepet qartë figura reaksionare, antikombëtare e atyre veladonezezeve, që për shekuj duke qenë përfaqësuesit e pushtetit shpirtëror të njerëzve, kanë luajtur ashtu siç thonë autori vetëm rol merimangash në vendin tonë, në endjen e atyre fijeve të njohura të errësirës mesjetare.

Vepra duke qenë një sintezë e konfliktit të ashpër klasor të shkallës kombëtare e ndërkombëtare, lot një rol të rëndësishëm për studime shkencore në fushën e historisë së vendit tonë dhe ka një vlerë të madhe për edukimin revolucionar të masave punonjëse..."

Por absurdi i shqiptarëve trushpërlarë nuk ka të sosur

Shqiptarët fatkeq në vendlindje, kanë menduar gjithnjë si naiv se shumica e shqiptaro amerikanëve këtu janë anti-komunistë, gjë që nuk ka qenë e vërtetë në kohën e regjimit komunist dhe as në ditët tona.

Dikur Jupi i gjithpushtetshëm në sektorin e albanologjisë deri sa mbylli sytë, është ftuar paturpërisht nga sociakomunistët shqiptaro amerikanë, që dikur shisnin në rrugët e New York-ut librat propagandistike të diktatorit anti-katolik dhe ateist Enver Hoxha dhe të beniamin të oborrit të tij "disidentit" Ismail Kadare.

Ata fatkeqsisht kishin marrë peng asokohe dhe sot Federatën Panshqiptare "Vatra" (1912) dhe gazetën pro komuniste "Dielli" (1909), që të vinte në SHBA dhe të bënte "hulumtime" selektive të njëanshme për disa nga figurat e shquara të diasporës sonë këtu, duke e paraqitur vazhdimisht të zezën si të bardhë.

Kjo taktikë komuniste dhe post-komuniste u përsërit disa herë edhe me ftesat dërguar "profesorëve" të komunizmit si prof. dr. Nasho Jorgaqi dhe prof. dr. Viron Koka, të cilët shkruan libra me përralla apo trillime, për leninistin e pandreqshëm apo

komunist e thekur hoxhist *Fan Stilian Nolin*.

Kundër shënimeve historike të **shqiptaro amerikanit veteran nga Bostoni dr. Peter Minnai** këtu në SHBA, janë hedhur në sulm mediatik plot fanatizëm studiuesit e shkollës së realizmit socialkomunist të Shqipërisë së diktatorit Hoxha, ndihmësit besnik të idedologjisë propagandiste komuniste të PPSH-së *prof. Nasho Jorgaqi dhe ndihmësi i tij prof. Viron Koka*.

I pari, ka shkruar një pamflet në fletushkën Ze(h)ri i Popullit dhe i dyti në një tribunë "demokratike" si Rilindja Demokratike ("RD"), por që në vetvete të dy vijnë nga indoktrinimi dhe shërbimi fanatik, që i kanë bërë sistematikisht për shumë dekada komunizmit të tyre.

Ndërsa i pari, qëndron në pozitë të një socialisti të konvertuar, i dyti i kthyer në formalisht me kostumin blu "demokrat", çoroditi edhe atë pjesë naëve të rinisë shqiptare pas viteve 1990, që pret realizëm, frymë kritike dhe freski në analizën e figurave të nacionit.

Gjatë verës së vitit 1994, dr. Minnar kishte planifikuar që sëbashku me fakte të pakontestueshme të vij në Shqipëri, për të tretën here, duke pranuar me kënaqsi një bisedë treshe përballë ekranit të televizionit, për të njohur publikun shqiptar nga afër dhe realisht me faktet origjinale pa retushime mbi leninistin fanatik Nolin.

Mirënjohja dhe respekti del nga zemra e njerëzve të kulturës

Kultura e madhe e Kolecit në zbardhjen e kontributit të klerit dhe elementit katolik ishte një dhunti dhe talent, që u fik shpejt nga kalimi i tij në amshim. Mons. Zef Simoni e kishte Kolecin si një këshilltar të sinçertë dhe shumë të mirë. Në bisedonim gjatë udhëtimeve me makinë në famullinë e Dajçit të Bregut të Bunës, ku meshtar ishte vëllai i tij **dom Gjergj Simoni (1933-2022)**.

Historia, kultura e thellë, letërsia dhe figurat e klerit katolik, ishin një passion, që i buronte natyrshëm nga thellësia e pastër e shpirtit qytetar shkodran. Pushoftë në paqe, në lumnin e pasosun!

Publicisti bashkëkohor dhe prelati i lartë i kishës katolike në Shqipëri **Shkëlqesia e Tij Ipeshkvi i Rrëshenit (2017) imzot Gjergj Meta** (lindur në qytetin e Durrësit në vitin 1976), do të shkruaj këto fjalë dhimbjeje nga zemra e plagosur e tij, për kalimin para kohe në amshim të intelektualit të shquar, por modest: *"Kolec Çefa paska vdekë! Paska vdekë një burrë i vyer! Lajmin ma dha Klaudia Bumçi e Radio Vatikanit. Më erdhi keq, por më shumë turp nga vetja që Koleci jo vetëm ka vdekë, por tashma edhe qenka varrosur në Shkodër e nuk kam qenë për me i thanë dy uratë e me ia hedhë një grusht*

dhe. Për ma shumë asnjë rresht nekrologji apo një kronikë sado të vogël lajmesh, së paku në të lokale të Shkodrës, për një njeri i cili ia kushtoi jetën e tij arsimit dhe kulturës, punoi me mons. Frano Illinë (dhe imzot Zef Simonin Ipeshkëv Ndihmës I Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër, shënimi im K.K.), botoi libra e shkrime duke lartësuar punën dhe rezistencën e klerit në Shqipëri, na dhuroi tekste kritike dhe dokumenta të panjohur për Fishtë, shkrime të shumta, përmbledhë në vëllimin: "Kur e vërteta flet ndryshe" botuar në vitin 2010. Koleci nuk mund të ikte kështu, anonim. Nuk e meritonte. Kolecin e kam njohur personalisht në Tiranë kur kam qenë prift krejt i ri në Katedralen e Tiranës. Aty vinte në meshë për çdo ditë diele... Kishte njohur pothuajse të gjithë meshtarët e varrë apo të burgosur e mund të fliste për secilin prej tyre. U kushtoi shkrime e jetshkrime, përderi edhe Marie Tucit të stigmatineve. Koleci me siguri, me fenë e gjallë që ka pasur, i është përgatitë asaj. Vdekjen ia kemi hak Zotit, por anonimatit nuk mund t'ia lejojmë vetes, sidomos për njerëz si Kolec Çefa që i kanë dhënë diçka vendit, shoqërisë, historisë dhe kulturës..."

Kolec Çefa: një pendë shqiptare katolike më pak (Radio Vatikan, 27 Gusht 2021)

U kthye përgjithmonë nga Tirana, në Shkodër, studiuesi dhe shkrimtari i njohur, Kolec Çefa, autor i disa librave e i një mori studimesh e artikujsh, botuar në mjetet e komunikimit të Kishës katolike si dhe në shtypin e kohës, posaçërisht në gazetën "Shqiptarja". R. SH. - Vatikan

Bashkësia katolike e Shkodrës përcolli në banesën e fundme Kolec Çefën, që u rikthye përgjithnjë nga Tirana, në vendlindje. Pranë familjarëve, në Varrezën e Rrëmajit.

Vëlla i poetit të mirënjohur Anton Çefa, lindi në Shkodër, më 26 shkurt 1937, në një familje katolike shkodrane, që banonte në lagjen Arra e Madhe.

Të dy vëllezërit ishin studentë të shkëlqyer, studiues dhe krijues të talentuar, por mbi të gjitha, njerëz të vërtetë, që zgjodhën rrugën më të vështirë: **atë të heshtjes e të harresës**.

Për të ruajtur më të kushtueshmen: dinjitetin. Në vitet e para pas '90-ës pati fatin të jetonte kohët e "ringjalljes", si sekretar e redaktor i veprave të imzot Zef Simonit, në kryepeshkvinë katolike të Shkodrës. Ndërsa Antoni, autor i dy librave me poezi, "Dritarja e një britme" dhe "Heshtja ka tingull guri" nga shtëpia botuese Camaj-Pipa 2002 u largua nga Shkodra - në Amerikë e aktualisht (jo sepse e është dorëhequr para disa viteve, shënimi im

K.K.), editor i Federatës Panshqiptare "VATRA" jeton e punon në New York (jeton në New Jersey prej shumë vitesh, shënimi im K.K.) me sytë, mendjen e zemrën nga oqeani e deti ... Koleci u nis për në Tiranë! Një pendë më pak për Shkodrën e pendave të arta!

Koleci u lidh që fëmijë me klerin katolik, lidhje që nuk e shkëputi as në vitet e zeza të persekutimit. Mësimet e para i kreu në shkollën 7-vjeçare që e kishte fare pranë shtëpisë, për t'i vijuar në atë pedagogjike. Si e pati kryer me rezultate shumë të mira, nisi të endet nga katundi në katund, si mësues kryesisht i lëndëve humanitare. Ishte kalvari i "të prekunve". E në rrugën e Kalvarit shtegtonte edhe gjatë studimeve me korrespondencë pranë Institutit Pedagogjik në Shkodër. Kur u hapën rishtas dyert e kishave katolike, ishte i pari që, duke dalë nga klandestiniteti, u vu menjëherë në shërbim të Kishës.

Puna e gjatë përkrah imzot Zef Simonit, si sekretar i tij në argjipeshkvinë e Shkodrës, i krijoi mundësitë të shfletonte e të studionte dokumente të panjohura, të shpëtuara prej arkiveve kishtarë.

Luajti një rol të dorës së parë në botimin e librit **"Martirizimi i Kishës Katolike, 1944-1990"**, Shkodër, 93, ku përfshihet edhe portreti i dom Ndre Zadejës, fryt i pendës së tij. Mori në dorë, si redaktor, një pjesë të mirë të veprave të meshtarëve, botuar gjatë këtyre viteve. Posaçërisht, veprat e atë Donat Kurtit.

Nuk e shkëputi kurrë lidhjen me Kishën, nisur që heret në përpjekjen për të mbledhur iskrat e mbetura pa botuar nga autorët më në zë të saj, duke u lidhur sidomos me **atë Viktor Volajn, redaktorin e veprave të Fishtës, sepse e adhuron Fishtë**. Ndaj Atij ia kushtoi edhe librin e titulluar: **"Nëpër gjurmët e Fishtës"** (Shtëpia Botuese Françeskane, Shkodër, 2003).

Me botimet e shumta kushtuar kryeveprave të klerit katolik, u bë sakaq penda më e njohur në lëmin e studimit të autorëve të ndaluar gjatë 50-vjetëve të regjimit komunist. Nuk ia përtoi të hyjë edhe në polemika, ndërsa vijon sulmi kundër trashëgimisë së tyre letrare.

Botoi një vepër edhe për Luigj Gurakuqin, titulluar **"Luigj Gurakuqi në një optikë të re"**. Shkrimet e tjera, që mbetën të përhapura në revista e gazeta, mund të përmbledhen në një libër shumëfaqësh.

Që të mos harrohet kurrë kontributi i tij dhënë Kishës Katolike e asaj kulture për të cilën krenohet Shkodra, ku penda të reja të talentuara ecin në gjurmët e pashlyera."

Lezha legjendare nderon Monsinjur Dr. Zef Oroshin



Frank Shkreli

Ditën e hënë më 13 dhjetor 2021 në Sheshin Gjon Pali II, Rruga Faik Konica në Lezhën legjendare, është zbuluar busti i klerikut të njohur, atdhetarit dhe anti-komunistit të shquar të diasporës shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mons. Dr. Zef Oroshit. Sa simbolike hapësira e zgjedhur nga planifikuesit e këtij projekti, për të vendosur bustin e Mons. Zef Oroshit në atë vend të identifikuar me këta dy emra të mëdhej: njëri i Kishës Katolike Shqiptare dhe tjetri një prej personaliteteve më të njohura të historisë së Shqipërisë. Dom Zefi ishte adhurues i madh i Papa Gjon Palit II dhe kishte respekt edhe për Faik Konicën, gjithashtu, si një patriot e shkrimtar i pashoqtë.



Pjesëmarrës në protestën para OKB-së, 1973 me Monsinjur Dr. Zef Oroshin, organizuesin e protestës kundër vrasjes makabër të At Shtjefën Kurtit, nga regjimi komunist i Enver Hoxhës.

Pasi unë kam shkruar në të kaluarën për vlerat fetare dhe kontributet kombëtare të Dom Zefit – të cilin e kam konsideruar këshilltar dhe besnik timin sa ishte gjallë;

